



Dukagjini

Botim Periodik i Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”, Viti i VIII i botimit, nr. 109, Nëntor 2012

Nr. Llog. BKT 410027968, Shkodër - Albania, Tel. 00355683191817, 0035692328116, internet: www.shoqatadukagjini.org, Kryeredaktor: Lazër Kodra, Çmimi 30 lekë / 1.5 euro

KRYESIA E SHOQATËS “ATDHETARE-DUKAGJINI” DHE REDAKSIA E GAZETËS



Të nderuar lexues dhe miq të gazetës Dukagjini ju urojme: Gëzuar 100 vjetorin e Shpalljes së Pavarësisë dhe ta kaloni me plotë mirësi! Me datën 29 nëntor 2012, ditën e çlirimit të Shqipërisë fillon dita e parë e 100 vjetorit të dytë të Shpalljes së Pavarësisë, për të cilin ju urojme: Asgjë nuk është e vetme! Hapësirës që jetojnë të gjithë gjallesat, nuk do të thoshin “Gjithësia”, në qoftë se gjithë përbërësit e saj nuk do të ishin bashkë. Ato jo vetëm që janë bashkë, por janë edhe në unitet njëra me tjetrën dhe i shërbejnë njëra-tjetrës në mënyrë të ndërsjelle, secili në peshën e vet. Prandaj të bashkuar të shikojmë dhe të punojmë drejtë së ardhmes së vetes, të femijeve tane, të nipave dhe mbesave tane, duke dhënë e mbjelle më shumë dashuri vetës dhe te tjerët se, vetëm kështu do të behem më të denjë për vete dhe për të tjerët në shërbim të së ardhmës, larg mentaliteteve të pushtuesit në shekuj, larg mentaliteteve që janë peng e së kaluarës, larg mentaliteteve të perjashtimit, larg mentaliteteve për të justifikuar dobësitë tona, larg mentaliteteve për të pare përgjegjësinë e mungesës te vetja-tek tjetri, larg mentaliteteve të vetëgjyqësive, larg mentaliteteve të parcelizimit të Dukagjint e të Nenlokës Shqipëri! Të bëjme përpjekje të njohim më mirë detyrat si qytetar dhe ti zbatojmë ato; të bëjme përpjekje të njohim më mirë të drejtat dhe të jemi më aktiv për ti siguruar ato; të bëjme përpjekje të jemi më të sinqerte njëri me tjetrin, të jemi më të besueshem ndaj njeri-tjetrit; të bëjme përpjekje që shteti i yne të jetë më i përgjegjshëm në sigurimin e jetës së shtetasve të vet dhe shtetasit e tij të kenë më shumë besim tek ai. Urime, Gëzuar dhe Lumturi, me faqe të bardhë drejtë së ardhmës!

2 “Shtatë Shaljanët”

Në Kuadrin e 100 vjetorit të Pavarësisë Bashkia Shkodër në bashkëpunim me Teatrin “Migjeni” nga data 21-23 Nëntor 2012, me sukses sollën në skenë për artdashësit shqiptar pas 54 vitesh drama “Shtatë Shaljanët” e Artistit të Popullit Ndreka Luca.

Rikthimi me sukses i kësaj drame është bërë i mundur falë punës së palodhur të regjisorit Fatbardh Smaja dhe krejt grupit të punës. Kjo u realizua falë dëshirës së mirë për ti dhuruar artdashësit shqiptarë çaste të këndshme, të cilat dinë të sjellin vetëm 100 vjetorët. E theksoj artdashësit shqiptarë, sepse edhe pse kjo dramë u shfaq në skenën e Teatrit “Migjeni” në të tri netët e shfaqjes drama u ndoq nga artdashës të ardhur nga Tirana, Ulqini, Tuzi, Peja dhe diaspora. Kjo pjesëmarrje të lë të mendosh se, artdashësi e kishte pritur me kohë një gjë të tillë. Por më mirë vonë se kurrë. Emocionet e dhuruar nga aktorët kanë sjellë duartrokitjet e shumtë dhe të shpeshta në sallë. Loja e aktorëve ju përgjigj më së miri etjes që artdashësi kishte prej kohësh.



DJALI I THETHIT NGJIT SHKALLËT E HOLLIVUDIT

- BASHKËBISEDIM ELEKTRONIKE ME AKTORIN PRAQ RADO (PREKË RADOHINA) -

4

REDAKSIA
Kryeredaktor: Lazër Kodra
Redaktorë: Drita Shyti, Roza Pjetri, Prelë Milani, Luigj Shyti, Suela Ndoja, Zef Nika, Florenc Buxha, Lulash Brigja

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP

Mundësoi Botimin:
GJERGJ LEQEJZA

Ma.di.sh PRODUCTION Kimay Produzione Giacche



Faleminderit o "Nderi i Kombit"

PRESIDENTI I REPUBLIKËS, BUJAR NISHANI DEKORON MALËSINË E MADHE ME URDHRIN "NDERI KOMBIT"

Malësia e Madhe, me bjeshe të begata e male të madhnueshme, është një nga trevat me interesante në pikëpamjen historike, ndoshta më shembullorja në pikëpamjen etnografike edhe me poetikja në të gjitha viset e larmishme shqiptare, ku pasqyrohet gjymtyra organike ma karakteristike heroike-patriarkore e malësorit shqiptar. Luftëtarë të repretë, që njëherë e një kohë askush nuk iu a pa shpinën. Homerik çakçirbardhe e xhamadan argjendte të pashëm e të stolisur, gaztorë e krenarë, personifikim i tharëve të lashta e të reja, dhe i të gjitha prurjeve të mira dhe jo të mira të shqiptarit si individ si fis e bashkësi. Femra të dëlira, punëtore, duararta, stanica të mrekullueshme, të hijshme e sensuale, me rrezatoret e botës alpine. Ajkunat, Norat dhe Tringa e Malësisë, shkëlqejnë si diell virtyesh me rreze të kullueme, me hiret e amazoneve dhe vetëmohimin e Evgjënise. Gjuha që rrjedh prej gojës së malësorit e pastër nga çdo

neogjenizem, tingëllon si këngët e kreshnikëve, si eposi i shqipeve të Fishtës, si gjuha e Budit, Bogdanit, Mjedes e Camajt! Malësi e Madhe amazone e sproueme qindra vjet në luftëra vigane plot burri e heroizëm. Kryefjale e kryengritjeve të pashuara, bujarja e tervesa ilire,

cilët i veshën në barut të zi këto monopate, por jo nuk nënshtruan, dragoit as zanat me xhublete të Malësisë.


Po zo' ç' ka ndodhi pas Kongresit të Berlinit?! Mos valle Malësia trime ua çeli derën ushtrive të huaja, që kërkonin shqyerjen e trojeve tona etnike?! Jo

500 vjetësh robëri, e para nder shoqe ngriti flamurin e Kastriotit të njomur me gjakun e dëshmorëve të shekujve të ringjallun nga hini i të vdekunve. Ky ishte flamuri i ngallnimeve tona të shkëlqyeshme, i bukur e rrezatues si drita e përthymë mbi vale, i dashtun sa vete jeta dhe



kuvendare e besëlidhjeve kombëtare. Asht në fyt, ferre në sy e gurë në zemër iu bane Asllan Pashës, Vuci Pashës, Mehmet Beut, Sulejman Pashës, Ibrahim Pashës, Turgut Pashës Mark Milanit Veshoviqit, Kral Nikolles, të

Malësia Madhe ashte ndeze flake e tym, dhe ashte lidhe besa-bese me Dukagjin, Mirdite e Shkodër me i dal Zot Shqipnise. Po Zo' ç'ka bani Malësia e madhe, me 6 prill 1911? Qebesa bani një kryevepër therore, pas



i shtrenjte sa të gjitha shpresat e shqiptareve. Ndërsa shqipja e moçme valëvitej mbi majën

e thepisun të Deçit shumë fatosa të Malësisë Madhe u flijuan në hije të tij. Lavdia dhe fatbardhësia e asaj dite historike, do të mbretnojë mot pas moti. Lulet tona le të mbulojnë varret e deshmorëve. Prilli i Dedë Gjon Lulit dhe "Libri i Kuq", që u miratua në Kuvendin e Grecës nga "Lordët i Malësisë" ishin parafjala e agimit të Nëntorit të dyte në Vlorë si dita me fatlume e kombit tone. Po zot ç'ka bani Malësi e Madhe me 1920? Me kushtrim ma të thekshme se pushka: Po ku je i thirri Vlorës?! Ti anej e unë kenej të qëndrojmë si na ka hije dhe ashtu qëndruen e shkruen një epepe lavdie kombëtare. Po Zo' ç'ka bani Malësia e Madhe me 1945?! U ndez flake prej komunizmit e këtu ma tepër se kudo tjetër, çdo gur u be ledh e perde e hekurt qëndrese, nga spartanet e kanunit Malësi e Madhe-bukuroshja bujare e zakoneve tona fisnike, parakalon si antike mini-arteriale iliro-ardhërore veshur me zhublën e saj mbretnore, e stolisun gjithë hirësi kuq e zi. Sot nën tingujt e Lavdit të Flamurit, Atdheut dhe Kombit që ti fale, burrim flije e ndere, të uron:-Faleminderit o "Nderi i Kombit", për mërsine dhe lumnimin që me dhe!

Prele Milani

"Shtatë Shaljanët"

Në Kuadrin e 100 vjetorit të Pavarësisë Bashkia Shkodër në bashkëpunim me Teatrin "Migjeni" nga data 21-23 Nëntor 2012, me sukses sollën në skenë për artdashësit shqiptar pas 54 vitesh drama "Shtatë Shaljanët" e Artistit të Popullit Ndreka Luca.

Rikthimi me sukses i kësaj drame është bërë i mundur falë punës së palodhur të regjisorit Fatbardh Smaja dhe krejt grupit të punës. Kjo u realizua falë dëshirës së mirë për ti dhuruar artdashësit shqiptarë çaste të këndshme, të cilat dinë ti sjellin vetëm 100 vjetorët. E theksoj artdashësit shqiptarë, sepse edhe pse kjo dramë u shfaq në skenën e Teatrit "Migjeni" në të tri netët e shfaqjes drama u ndoq nga artdashës të ardhur nga Tirana, Ulqini, Tuzi, Peja dhe diaspora. Kjo pjesëmarrje të lë të mendosh se, artdashësi e kishte pritur me kohë një gjë të tillë. Por më mirë vonë se kurrë. Emocionet e dhuruar nga aktorët kanë sjell duartrokitjet e shumtë dhe të shpeshta në sallë. Loja e aktorëve ju përgjigj më së miri etjes që artdashësi kishte prej kohësh.

Kam pas fatin që dramën ta ndjek për tri netët dhe dua të veçoj lojën e njëjtë të të gjithë aktorëve. Kjo tregon impenjimin e madhe që ata kanë treguar në

përgatitjen dhe vënien në skenë të saj. Regjisorin Fatbardh Smaja me mjaft mjeshtri ka gërshetuar eksperiencën e aktorëve profesionist me aktorët e tjerë ku ne nuk arritëm të kuptojmë se kush ishte profesionist dhe kush amator. Ky është vërtet sukses.

Në të gjitha komponentët e saj drama solli suksesin. Duke ja nisur nga interpretimi i aktorëve, skenografia e cila të merrte me vete e të çonte në Shalë dhe menjëherë të zbrishte në saraje. Muzika e cila e paraprinte ngjarjen dhe ti shtonte emocionet. I falënderojmë të gjithë për emocionet që na dhuruan por nuk mund të mos i falënderojmë në veçanti aktorin

e ri, por me një të ardhme të madhe Jozefin Shiroken në rolin e Deli Pjetërës, Ritën Gjeka në rolin e nënës së Delisë, ku fjalët e saj të godisnin në krahërore e të thoni: -Dëgjo, Atdheu bir, Atdheu të do ty. Si gjithmonë e mrekullueshme në rolet e besuar aktorja Merita Smaja. I veçantë dhe mjaft befasues ka qenë për të gjithë artdashësit

interpretimi i Drane Xhajt, e cila në rolet e saj gjithmonë na ka bërë të qeshim dhe kësaj radhe ajo na dhuroj shumë emocion. Një mesazh bashkimi mjaftë të fortë e solli aktori Enver Hyseni në rolin e tregtarit. Spikati interpretimi i Tomas Delisë dhe Geg Shpatit, të cilët me originalitet e sollën Shaljanin të fortë dhe këmbëngulës. Spikati me mjaft



finet interpretimi i Gac Kodrinës në rolin e tij. Të luash heroin është bukur, sepse do të hysh në zemrat e njerëzve edhe si aktor, por të luash armikun është e kundërta dhe këtë ndjenjë na krijuan gjatë interpretimit Gysi, Zefi, Paulin, Agroni dhe Qazimi të cilët sollën armikun shekullor të popullit Shqiptarë me mjaft mjeshtri.

Duke parë lojën e aktorit të ri Emiljani Palalit dhe të rinjve të tjerë krahas falënderimeve dua ti bëjë apel pushtetit lokal në Shkodër që ti përkrah këto talente të reja. Sepse në skenën e Teatrit "Migjeni" para 54 vitesh e kanë luajtur të tjerë aktorë këtë dramë e kësaj radhe nuk ishte asnjë prej tyre. E kam fjalën, ne duhet të mendojmë edhe për të

ardhmen e këtij teatri. I falënderoj të gjithë grupin e punës që e realizuan shumë mirë këtë dramë dhe kjo e përsërisë, falë eksperiencës së regjisorit dhe aktoreve profesionist që dhanë maksimumin pa u menduar shumë se si do të shpërblehen financiarisht. Në teatër duhet të pranohen edhe studentet e ri në qe po për-

fundojnë akademinë e Arteve. Çfarë kanë mësuar në Akademi është vetëm fillimi i jetës së tyre si aktor. Por të punosh në emër të së ardhmes së artit shkodran ju ftoj ti hapni dyert për talentet e reja.

E në fund, falënderimet e përzemërta për drejtorin e Teatrit "Migjeni" Edmond Angonin, i cili ka ditur të organizoj çdo

gjë shumë mirë. Madje që në pritjen e artdashësve tek dera duke vënë në pritje disa vajza të veshura me kostume tradicionale. Kjo pritje të përgatiste për tu futur në atmosferën dukagjinase. Faleminderit!

Me këtë rast, kryesia e shoqatës "Atdhetare-Dukagjini", vendosi të nderojë me titullin "Mirënjohja" e Shoqatës, Teatrin "Migjeni", me motivacion: "Në shenjë respekti e mirënjohje, për kontributin dhe ndihmën që ka dhënë në mbështetjen dhe ekspozimin e vlerave të qëndrueshme artistike e kulturore të dukagjinaseve. Për nivel të lartë artistik të rivënë në skenë dramën "Shtatë shaljanët". Gjithashtu nderojë me titullin "Mirënjohja" e Shoqatës, Trupën e vënies në skenë dramën "7 shaljanet", me në krye regjisorin e talentuar Fatbardh Smaja, me motivacion: "Për interpretimin me shpirt krijues, ndjenjë dhe kulturë të lartë artistike të kësaj drame"

Mesazhet e përcjella nga drama të emociononin sa që të vinte të thoshe: "Kjo është dashuria e vërtet për Atdheun". Ky është kuptimi i vërtet i Nderit dhe Burrnisë. Nuk na mbetet të themi shumë fjalë në lidhje me këtë eveniment, por faleminderit të gjithë atyre që na e dhuruan shfaqjen e kësaj drame.

Nga Roza Pjetri

Rreth librit "SHOSHI"



Përgatiti
LAZËR KODRA

Besoj se çdo i shoshjanë, kudo që ndodhet, e ndjene veten sot me mire se nga ç'ishte dje. Dhe kjo, fale ketij libri shume voluminoz dhe shume te gjere, te shkruar nga Prele Milani pikerisht mbi vendlindjen e tij, ku u lind dhe u rrit. Edhe autori i librit nuk ka pse mos ta ndiej veten krenar, brenda modesties se tij qe e karakterizon, per sherbimin e vyer qe i beri krahines se tij, Shoshit. Sipermarje te tille nuk jane te lehta, madje ato u perkasin vetem njerezve erudite, te perkushtuar e kurajoz, siç eshte Prele Milani. Ne kushtet e nje shprishje te unitetit territorial dhe unitetit fisnor te shume krahinave malore te Shqiperise, pas viteve 90, nuk mund te kete unifikim me te mire te vlerave te te shkuars dhe te tashmes se sa nje liber i tille, te cilin do ta quaja "Bibla e Shoshit". Autori nuk i perket atij grupimi njerzish qe motivohen nga etje per lavdi vetjake dhe sulen te mbushin faqe libri apo gazete, vetem e vetem per nje emer.

Autori kerkon qe t'i jape kutpim jetes, jo vetem jetes se vet, por edhe asaj shoqerore. Frymezimi per kete liber, siç ma thene vete autori, ka lindur kohe me pare, ndersa sprovat per te kane qene te shumta derisa "uji dhe mielli" kane gatuar kete buke te gjeishme e te pjekur mire per "stomakun" e vetedijes sone. Veshtrimi i Z. Milani ne kete liber eshte i thelle dhe gjithperfishires, duke u ngjeshur ne mbi 500 faqe liber gjeografia hapsinore e Shoshit, drejteza e pafundme kohore e disa shekujve, aktoret qe e luajtjen jeten, me te mirat dhe te keqijat qe sjell ajo, ne kohra dhe periudha te ndryshme.

E konceptuar si nje Triologjo, do ta konceptoja une, ky liber nuk le shteg, ne mos fare, krejt minimalisht per kontestime, te cilat duhet pranuar se i bejne mire çdo libri te çdo autori, qofte edhe boteror, aq me teper ne keto kohra ku shpuza e mendimeve te ndryshme nuk ka te ndalur ne asnje moment.

Libri Shoshi (Gjeografia, gjeneologjia, historia) mbeshitet mbi supet e dymbedhjete kapitujve, ku sejcili pason tjetrin mbi bazen e nje rrjedhe te logjishme e te mirekombinuar, ku elementet natyre-shoqeri-histori funksionojne ne liber ne menyre integrale perkrah njera-tjetres, ne ndihme e funksion te qellimit final te ketij libri.

Ne kapitullin: "Relievi dhe kushtet natyrore" bie ne sy qartazi potenciali ditunor qe zoteron autori ne kete sferë. Shfrytëzimi i literatures referenciale, dhe statistikave te shume e shume viteve, shkelja me kembë e atyre trojeve dhe regjistrimi i kujdesshem i çdo ndryshese ne kalendarin e tij, mbrujta e tokes nga

duart e tij pellembe per pellembe, per-tylja e çdo lloj fruit ne bjeshke apo vrri, "bashkebisidimi" me çdo lloj kafshe jane ato gjera qe e kane bere autorin te besueshem. Shoqerimi me albumin fotografik perkates i jep ketij kapitulli gjithë tejdukshmerine e nevojshme per të. Duhet thene se vetem ne kete kapitull ka mbi tridhjetë referenca nga revista e shkencetar prestigjioz te se kaluars. Kapitulli: "Fshatrat e shoshit" qe varion nga faqja 43 deri na faqen 170 eshte mjaft mbreselene. Eshte mbreselene per faktin e shfrytëzimit ne maksimum te dokumneteve historike te shfrytëzuara nga autori, nga mendimet e terhequra nga baskepunteret e tij te shumte. Eshte mbreselene edhe per faktin se autori ka arritur t'i tipologjizojë me te veçantat dhe te perbashkta qe kane secili fshat me tjetrin. Eshte mbreselene per faktin e renditjes se numrit te familjeve dhe emrave te pjestareve te seciles prej tyre, dhe nje mbrese te veçante lënë toponimite e shumta, te cilat nuk merr persiper per t'i spjeguar ato ne rrafshin e etimonit te tyre. Edhe ne kete kapitull kemi plot pesdhjet e nente referenca, secila me thelesin dhe besueshmerine e larte.

Kapitullin: "Gjeneologjia e vllaznive te Shoshit" do ta quaja si kulmin e betejes mes autorit ne njeren anë dhe librit e lexuesit ne anen tjetër. Nje endje qoshk me qoshk e dere me dere i kane dhene guximin e duhur autorit per kete kapitull. Nje shfrytëzim ne maksimum i materialeve historike te disa shekujve i ka dhene fortesine e qendrueshmerine, ndersa menyra e renditjes se tyre i ka dhen brishtesine e embel dhe delikatesen e perthyerjes. Nese dikush do te kishte ndonje verejtje per ndonje rreshqitje te vogel, eshte e udhes te mireperdoret nga ne dhe te pranohet nga autori, Si mendon ju: Do te ishte me mire qe nje liber prej mbi pesëqind faqesh te rridhte vaj dhe ne te mbeteshim te shushatur apo te kishte edhe ndonje vickel me te cilen te qeshnin nje here? Besoj se jeni dakord me te dyten. Per kete edhe vete autori, duke e ndier peshen e nje rrefimi te duhur objektiv, ka mbartur ne fund te faqeve dhjetra referenca nga njerez bshkekohor te tij. Keshtu qe i bie te jete bashkeautor dhe bashkepergjegjes me ta, nese me lejohet ta formuloj ne menyre te tille.

Ne kapitullin: "Fisi-bajraku, organizimi hierarkik", besoj se autori e ka ndiere mbi supe peshen e fjales se pergjegjshme, dhe ne kete moment e perfytyroj me shpatulla te krrusura, por qe i ka bere shume mire, pasi peshë e netos e ketij kapitulli ka nje vlere shume percaktuese ne kete liber. Ky kapitull nuk spjegohet me fjale te pakta, siç jane keto te miat, por me nje studim te mirefillte qe mund t'i beje secili. Paraqitja grafike qe i ka bere autori eshte nje ndihmese ne sherbim te lexuesit, per t'i krijuar atij mundesine e perthihitjes më me lehetesi të të tërës dhe krijimit te vizionit te qendrueshem. Jane plot tetedhjetë e nje referenca qe piksojne çatinë e ketij kapitulli potencial.

"Shoshi ne fokusin e legjendave te vjetra" eshte nje kapitull disi shlodhes edhe per autorin edhe per lexuesin.

Me kuptimin shlodhes most e krijojme idene e pavlfshmerise, sepse keshtu do te gabonim rende. Kjo argumentohet me faktin se te gjithë ne e kemi nje pikenisje, dhe kjo pikenisje e ka zanafillen ne mitin gojedhenen e legjenden popullore, ketij gjeniu te pazevendesuseshem. Perkundraz ky kapitull eshte nje ure lidhese e se shkures se largët dhe asaj qe sot ne e quajme periudhe modern. Krahasimisht, sot bota nuk do te kishte "Iliaden" dhe "Odisenë" po mos ta runte popyulli grek per disa qindra vite ne variantin e folur dhe, dhe sipas pak te dhenave mos ta kendonte e shkruante, i verbri Homer. Ky kapitull, e them me plot gojen, eshte deshmi e gjalle e mençurise se popullit te hershem shoshjane dhe interpretim i vleres se tij.

Të bësh histori nuk eshte e lehte, madje sipas studjuesit e psikologut dukagjinas, Lekë Sokoli, studimi historik perballat me tri veshtersi te medha. Ato jane-1-Koha e kaluar nuk kthehet më.-2-Ne histori nuk mund te kryhet eksperiment;-3-Nese burimi referencial eshte i paanshem persa i perket atij të cilit i referohesh(kjo e fundit mbeshitet ne arsyetimin se çdo njeri ka nje bindje drejt te ciles anon edhe kur pretendon per ekuilibër perfekt). Të gjitha keto e kanë bere autorin e librit te jete shume i kujdesshem ne kapitullin: "Antologjia historike e Shoshit". Ky kapitull eshte i ngjeshur dhe i dendesuar plot figura ne vetem njezet e dy faqe libri, nderkohe qe referencat per to jane plot gjashtedhjetë e nje. Kjo n'ambush mendjen se autori u ka besuar referencave dhe i ka shkruar te gjitha ato, duke na krijuar mundesine edhe ne lexuesve qe midis alternativave te perzgjedhim edhe më të arsyeshmen. Nepermes personazheve kryesore historike te ketij kapitulli si: Marash Tuci, Sokol Tona, Zekë Jakini, Pal Gjoka, Bush Delia, Babun Celi, Mark Milani Zef Delia etj. janë pasqyruar të gjitha motivet shpirtnore tipologjike te Shoshit si: Trimeria, bujaria, besa, kundershia deri ne flijim ndaj çdo lloj pushtuesi. Per kete, mendoj se ky kapitull sherben si truall i paplasarituri i qendreses shoshjane nder shekuj.

"Atdhetarët të shquar të traditës" eshte nje kapitull jo shumëfaqesh, por në menyre simbolike figura të tilla si: Ndokë Mirashi, Ndoc Deda, Uke Staka, Dede Ndou, Gjon Marashi, Balë Marku e te tjere krijojne idenë e percjelljes se ndjenes tradicionale te patriotizmit, nga njeri brez në tjetrin si nje relike e çmuar e popullit të asaj zone lavdiplotë. Tridhjetë e tete referencat e perdorura ne kete kapitull na bindin definitivisht se autori i librit nuk vuan nga deliri i madheshitese dhe i tendences per te pronesuar a per t' i adresuar lavditë e paqëna tek zona e tij, Shoshi.

Kapitulli: "Martiret antikomunistë", eshte vertetë tragjik. Prelë Milani, para disa kohesh i anatemuar, i epitetizuar e deri diku edhe i mallkuar e i ndeshkuar, e perjeton personazhin e tij ne kete kapitull me gjithë fuqinë e dhimbjes njerezore. Kjo eshte veçori e njerezve që perpara jeteve njerezore nuk vë as paranë as pushtetin as lavdinë fallso. Gjëlosh Lulashi, Gjëlosh Lushi, Bekë Delia, Kolë Deda, Kokerr Kola, Dede Mhilli, Vogel Kola, Ndue Delia, Lulash Gjëloshi e shume te tjere jane ato personazhe fosforoshente

qe ekspozojne më së miri kalvarin tragjik te epokes se komunizmit dhe njekohsisht qendresen e tyre pa marre parasysh se u kushtoj ajo ma e shtrenjta, Jeta, te cilien ashtu siç ta fale Zoti ashtu ka te drejte t'ia marre vetem Ai.

"Elita kulturore e Shoshit" eshte nje kapitull qe mahnit këdo që ta lexoje, jo vetem brenda territorit te Shkodres, por edhe ne shkalle nacionale. E them kete shume i bindur, pasi nje pasuri e tille inetelektuale mund te perfaqesojë nje komb të tërë, e jo nje krahinë te vogel ne permase gjeografike e popullsi. Profesor Kole Prele, At Çiprian, Dr. Gasper Shoshi, Major Mark Mala, Don Preke Ndrevashaj, Lekë Vojvoda, Ndue Logu, Shtjefen Palushi, Gjergj Laca, Zef Shoshi, Hile Staka, Edmond Mehilli, Frederik Ndoci, Prele Gjoka, Kolë Gurashi, Ton Gasper Shoshi e te tjere deshmojne qartazi se nga trojet e Shoshit kane dale potenciale intelektuale te tilla qe kane cikur me plot dinjitet nivelet e artit evropian. Edhe ketu shtatdhjetë enenete refencat jane aq sa funksionale ne drejtim te besueshmerise, as bindese edhe ne funksion te madheshitese se ketyre njerezve shoshjanë.

"Ngulmimet e Shoshit" eshte nje kapitull shume terheqes, i thelle ne mendime, i mbeshitetur ne deklarime okulare e deshmi referenciale. Nje pune shume e lavderueshme e autorit. Ketu ne bindemi se autori ka ecur me lapse në xhep edhe kur punonte ne Shosh, edhe kur punonte ne Shkoder, Puke, Burrel e gjetke e deri tek ato që do t'i quaja ekspedita studimore ne Kosove. Tashmë shoshjanet i kane bijte dhe vellezerit e trojeve te tyre edhe ne Beltojë, Dajç, Grizhë, Urë e Shtrenjtë, Gjakovë, Mes, Sheldi, Mat, Durres, Elbasan, Fier, Berat, Tiranë, Pejë, Diber e ne shume vise te tjera. E gjitha kjo, sot, vertetohet jo më me amatorizem historik, por me fakte historike te vertetuara katerciperisht nga autori i librit.

"Statistikat dhe dokumentet historike" perbejne nje kapitull i cili nuk pranon koment. Arsyja është se stistikat e dokumentet nuk kanë nëntekst, apo lexim brenda rreshtave. Ato duhen pare nga secili. Ato sherbejnë si ato qoshet mjeshtrore qe vendosen ne kater anet e shtepisë, per te mbajtur atë të drejtë dhe të qendrueshme. Ne kete kapitull, ato jane te shumta dhe perçojne vlere realiste per gjithë librin ne tërësi. Persa i perket klasifikimit te teksteve, historia futet tek tekstet joletrare, por megjithate Z. Milani nuk ka arrite që t'i shpetojë tundimit dhe admirimit peerr personazhet e tij, ndaj shpeshhere bota e tij subjective ka interferuar ne liber. Kjo nuk e ka demtuar librin. Perkundraz i ka dhene atij nje frymemarrje te brendshme, nje frymë që në të vertetë eshte fryma e autorit, qe e ndien vetev tersisht te homogjenozuar ne librin e tij.

Per kapitullin e fundit: "Permbyllje" nuk do te bej asnje koment, por do te citoj nje fragment: Kur e pyeten iluministin dhe filozofin francez Monteskje: "Kush jeni ju? Ai u pergjigj: "Së pari jam Njeri, Rastesisht kam lindur ne Francë", ndersa Prele Milani, rastesisht ka lindur ne Shosh, Shoshi i dha gjithçka të mire, ndersa Ai sot ia kompensoi me të gjitha energjitë pozitive që ka breda vetes.

DJALI I THETHIT NGJIT SHKALLËT E HOLLIVUDIT

- BASHKËBISEDIM ELEKTRONIKE ME AKTORIN PRAQ RADO (PREKË RADOHINA) -

Fëmijëria dhe familja juaj, vështirësitë ekonomike?

Ne kishin trashëguar një varfëri të madhe familjarisht. Familja jonë përbëhet nga 8 veta. Shtëpia jonë është buzë lumit që jo radhë ngrihej shumë nga shirat. Ajo ishte shumë e vjetër sa që rrezikohej që të binte brenda. Zhurma e lumit na shoqëronte gjithmonë. Lagja jonë është shumë e bukur. Kujtoj dimrat e ftohtë, veçanërisht kur shkonim në shkollë. Babi Nikolla dhe nëna Marie nuk kishin mundësi për të siguruar të ardhura për të meremetuar shtëpinë, me vështirësi na siguronin bukën dhe ushqimin. Unë, motrat e mija Liza, Luçja dhe vëllezërit Gjini, Gjoka dhe Rroku ishim të vegjël dhe nuk kishim mundësi që të punonim për të përmirësuar jetesën. Ne jetonim në një shtëpi që në katin e parë kishim bagëtitë dhe në katin e dytë jetonim ne, ndërsa për te fjetur ngjiteshim në çatinë e shtëpisë, në një mjedis të ftohtë, sidomos në dimër. Shpesh në dimër kur frynte erë bora futej brenda. Më kujtohen kur vinte nëna dhe na pastronte borën para se të ngriheshim nga shtrati.

Praq, nxënës shkollë në Theth, largësia, vështirësitë e motit?

Shkollën e kemi pasur rreth një orë larg nga shtëpia. Kishte mjaftë vështirësi në veçanti gjatë dimrit dhe ditëve më mot të keq. Veshjet tona nuk ishin për të përballuar në kushte normale kushtet atmosferike. Në shkollë, mësuesit bënin mjaftë përpjekje për të na afruar më pranë stufave të zjarrit sidomos ne që ishim më larg nga shkolla, por shpesh mungonin edhe mjetet ngrohëse.

Sa i kujton shokët dhe shoqet e shkollës së fëmijërisë, kujto disa. Po mësuesit, përshtypjet për ta, a mund të kujtosh disa?

Ne ishim disi të mënjeluar nga që nuk e kishim biografisë e mirë, por gjithsesi shokët e klasës dhe shkollës na mbanin afër. Shumë nga nxënësit na ndihmonin në mësim. Edhe mësuesit përpiqeshin mjaft që të na mbanin afër. Kujtoj me respekt për ngrohtësinë që përpiqeshit të na krijonit, për mbajtjen afër, ty që po bashkëbisedojmë, mësuese Prenda Çardaku, Gjyste Shyti, Zef Bari, Gjokë Verrishta, Sykë Çarku, etj. Kam kaluar mirë me të gjithë sepse isha fëmijë i urtë që të paktën nuk shkaktoja probleme disipline e rregulli në shkollë.

Dëshira për një jetë më të mirë. Largimi nga Thethi, pse, vështirësitë e rrugëve të botës?

Gjithmonë kam pasur dëshirë për diçka më shumë në jetën time, të shkëputem nga vështirësitë në të cilat ishim, të përmirësojmë jetesën. Në fillim nuk dija se për ku po shkoja ose ku do të përfundoja. Rrugët e botës paskan qenë shumë të vështira. Duke bredhur nëpër botë, mendja me shtyrë që ti drejtohem Amerikës, qendrës së zhvillimit dhe demokracisë më të madhe në botë. Atje mendova se mund të gjeja qetësinë dhe mundësinë për një jetë më të mirë.

Humbja e Prindërve (dritë paçin) dhe mos marrja pjesë në përcjelljen për në banesën e fundit?!

Vdekja e prindërve të mijë ishte një humbje shumë e madhe për mua dhe motrat dhe vëllezërit. Mua më duket edhe më e madhe sepse nuk pata mundësi që të marr pjesë në përcjelljen e tyre, që tu hell një grusht dhe mbi varrin e tyre. Prindërit e mijë ishin shumë zemërbardhë, nuk i kanë bërë askujt keq. Vështirësitë ekonomike i detyronin prindërit e mijë që të merrnin borxhe dhe për ti larë



merrnin diku tjetër, pra borxh se borxh, por askënd nuk gënjenin, prandaj kishin respektin e të gjithëve. Jo se ishin prindërit e mijë, por vërtetë kanë qenë njerëz të mirë, të bekuar.

Prindërit e mijë i kam dhe do ti kem gjithmonë në zemër e gjithmonë do të më mungojë. Për mua ata nuk kanë vdekur, por janë bërë engjëj në qiell dhe janë me mua në çdo vend, kudo, në gëzime e vështirësi.

Vështirësitë e fillimit të integritimit në Amerikë, si mundët që ti kaloni?

Vështirësitë e fillimit në vendin e huaj, që nuk e ke parë as në ëndërr gjithmonë janë të shumta. Unë kisha dëshirë që bëja diçka më shumë, se sa të vija këtu, të haja bukë, të krijoja familjen dhe kisha fëmijë. Dëshiroja që të bëja karrierë, të bëja emër për vetë dhe

familjen time që e kisha aq të mirë.

Si arrite të regjistrohesh dhe për çfarë fillove shkollën në Amerikë?

Të shkosh në një vend problemi i parë është gjuha e ati vendi. Unë fillimisht fillova shkollën për gjuhën angleze. Pas kësaj mbarova shkollën e mesme me korrespondencë dhe fillova shkollën e lartë për radiologji. Më vonë ndërrova degë dhe vazhdova për aktrim. Nuk ishin të lehta për mua këto shkollime. Në vështirësitë që takova gjatë studimeve në Amerikë kuptova se nuk kisha mësuar sa duhej në shkollën e 9 vjeçare.

Rasti i "artë" për tu bërë aktor filmash në Amerikë. Si e ndjeve përzgjedhjen tende për të luajtur në këtë film?

Akrimi nuk është i lehtë as kund dhe aq më tepër në Amerikë, aq më tepër në mjediset e Hollivudit, sepse ka shumë konkurrent. Ndjehem me shumë fat dhe jam i lumtur që mu dha rasti të marr pjesë në këtë film. Puna dhe rezultati im, mendoj se do të ndihmojnë që Thethi dhe Dukagjini të vendoset më fuqishëm në hartat amerikane, që njerëzit të dinë më mirë se ku ndodhen Thethi dhe Dukagjini.

Si ndjehesh kur e shikon këtë filmin "Ëndërroj të jem amerikan" sa paraqet jetën tënde, a do të ndryshojë ndonjë po të kishe mundësi?

Në çdo moment që e shikoj këtë film ndjehem shumë krenar. Edhe po të jepej mundësia nuk do të ndryshoja asgjë, është perfekt kështu si është. Aty mund të gjejë veten çdo emigrant që është në Amerikë. E konsideroj vlerën më të madhe në jetën time, që unë një djalë malësor nga Theth të arrij të punoj me regjisorët më të famshëm në Amerikë. Kjo më mobilizon për punë më të madhe dhe synime të mëtejshme në të ardhmen.

Lidhjet e sotme me vëllain dhe motrat, sa të lidhur jeni?

Me vëllezërit dhe motrat jemi shumë të lidhur. Na mungojnë shumë takime nga afër, por nëpërmes mjeteve elektronike bisedojmë, shkëmbejmë mendime dhe ndiejmë afër me njeri tjetrin. Liza banon në Angli e martuar me Tonin Markvukaj dhe kanë gjashtë vajza shumë të mira, Luçja jeton në Greqi ka një vajzë. Në Greqi është edhe vëllai Gjoka. Gjini është në Amerikë, ndërsa vëllai i vogël Rroku jeton në Shqipëri. Të gjithë janë shumë mirë, por na mungojmë shumë babë e nënë.

Sa ndjehesh thethjanë sot?

Thethi është një vend i mrekullueshëm dhe me njerëz shumë të mirë. Unë gjithmonë jam ndjerë dhe gjithmonë do të ndjehem thethjanë me zemër dhe mendje.

Ai që harron vendlindjen e tij, sidoqoftë ajo, nuk ka jetë dhe as rezultate pozitive në asnjë vend ku do që të shkojnë.

Emri Hollivud është shumë i madh, sa afër mendon se e ke aktualisht?

Unë mendoj se jam shumë afër Hollivudit. Veçanërisht gjatë vitit 2011 kam bërë emër shumë të mirë dhe po ndjehem shumë krenar. Hollivudi është i madh dhe është shumë vështirë, ka konkurrencë të fortë, por kam besim se do të arrij sa më lart. Të jesh aktor e të bësh filma nuk është e lehtë, e, sidomos jashtë vendlindjes tënde.

Vështirësitë e përballimit të kamerave, dritave, përsëritjeve të lëvizjeve?

Vërtetë kamerat, mikrofonat, dritat, etj, të mbajnë disi nën presion, por me thënë të

drejtën jam përshtatë shumë shpejt aq sa kur ndodhem para tyre ndjehem si në shtëpinë time.

Keni thënë se, këtë film dëshironi që të bëni më metrazhe të gjatë dhe fillimin e filmit ta xhironi në Theth, a keni shpresë për realizuar këtë?

Po kam thënë dhe kam shumë qeft që Thethi të pasqyrohet në Dreaming American, atëherë do të ndjehem se kam plotësuar ëndrrën time në këtë drejtim. Unë kam besim se do ti vijë koha shpejt edhe kësaj pune.

Sa lexoni dhe çfarë preferoni më shumë?

Kam shumë qeft leximin e librave. Më të preferuarat tash për tash janë ato që flasin për filma, drejtim dhe aktrim. Në ato libra tregohet për vështirësitë dhe mundësitë e arrijtes së suksesit.

A mendoj shpesh për vendlindjen, Thethin dhe Shqipërinë?

Po, mendoj shumë herë. Më ka marrë malli edhe për gurët e malit. Shpresoj që së shpejti të vi dhe të çmallem më të gjithë.

Sa ndiqi dhe çfarë u pëlqen më shumë në valët e televizioneve shqiptare. Çfarë do të dëshironit të shikonit më shumë te TV Shqiptare?

Me thënë të drejtën nuk kam shumë kohë të shikoj TV. Nga Shqipëria kisha pasur qejf që të shikoj më shumë filma. Me çfarë kuptoj unë ata janë të dhënë më shumë në drejtim të muzikës. Do të dëshiroja që industria e prodhimit të filmave në Shqipëri të lëvizte më shumë.

Çfarë do të thoni për moshatarët tuaj thethjanë e shqiptarë, për të realizuar dëshirat e tyre?

Mbi bazën e përvojës time them se duhet të jemi të papërkulur, të përpiqemi të bëjmë të ditur me kulturë dhe durim mundësitë tuaja. Gjithmonë duhet të kemi besim në vetvete.

Sa ndjeheni të vlerësuar nga vendlindja juaj?

Unë nuk jam në dijeni të plotë të përhapjes së punës dhe rezultateve të mija në Shqipëri. Kanë shkruar disa gazeta, këtë e di. Jo vetëm për mua por për të gjithë emigrantët shteti Shqiptar është mirë që të kenë më shumë interesim dhe mbështetje.

Unë kam një ndjesi shumë pozitive që jam i përzgjedhur në 100 njerëzit e veçantë, dhe kur në të njëjtën kohë shfaqet filmi im dhe del në qarkullim libri në festivalin e filmimit në Tirana Internacionale në kuadrin e 100 vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë, ku përfshihem edhe unë. Ndjehem shumë i vlerësuar dhe u jam mirënjohës organizatorëve dhe përzgjedhësve. Dua të falënderoj me gjithë zemër botuesen e librit Flora Nikolla dhe Agron Domin për ftesën në festivalin e filmit.

Tashmë jeni i rritur dhe artist që po bën xhiron e botës, si ndjehesh që një ish mësues i yti të bën një intervistë.

Ndjehem shumë mirë, dhe i respektuar. Shfaqë respektim tim të thellë për ty dhe familjen tënde. Nuk më ka shkruar ndërmend që të vinë kjo ditë që të më marrësh në intervistë për karrierën time. Të falënderoj me mirënjohje.

A mund të bëni një urim, në mbyllje të kësaj interviste, për thethjanët në veçanti dhe shqiptarët në përgjithësi.

Urimi im buron nga zemra për të gjithë thethjanët e mijë të dashur dhe gjithë shqiptarët kudo që ndodhen. Urime shumë të përzemërta për 100 vjetorin e Shpalljes së Pavarësisë. Urime edhe për Krishtlindjen dhe Vitin e Ri 2013. Ju dëshiroj gjithë të mirat personale dhe familjare të gjithëve.

Urime shoqatës "Atdhetare Dukagjini" dhe gazetës së sajë "Dukagjini".

Ishte kënaqësi bashkëbisedimi me ju, ndonëse në distancë, por shumë i përzemërt.

Faleminderit!

Bashkëbisedoj, **Luigj SHYTI**

Një bashkëbisedimin me Gjok Arrën:

I nderuar Gjok Arra!

Në vizitën që bëra në shtëpinë tuaj, me datën 5 shtator 2012, ku gjeta respekt, mikpritje e bujari nga prindërit tuaj, gjate bisedës që bëra me babën tuaj, Pjetrin, mbi një raft të shtëpisë pashe disa punime, mu duken punime druri, punime artistike, punime portretesh e objekteve të tjera. Për momentin, nuk të pyeta, nuk u futa në bisede me ty se, u përqendrova shumë në gjen-ezën e fisit tuaj në veçanti dhe në tërësi për fisin e Vukajve! Më vonë i kam thënë vetes, pasi bisedova edhe me bashkëpunëtore të punës, në veçanti me mikun tim dhe bashkëpunëtorin në drejtimin e Shoqatës "Atdhetare-Dukagjini", Luigj Shyti, që të bëhesh pjesë e publikimit në gazetën e shoqatës të pagëzuar me emrin "Dukagjini", si një vlerë e kohës që vjen nga ndonjë trashëgimi familjare, apo dhunti e veçantë e jotja. Prandaj, dua të bisedojmë bashkë për punën artistike të tuajën

Kush është Gjok Arra?

Ju falënderoj dhe ndiejë krenari që po bëhem objekt i gazetës me një emër shumë të dashur për mua, me emrin "Dukagjini". Jam një djalë 26 vjeç, nga fshati Gjuraj, i komunës së Pultit. Rrjedh nga një familje malësore tipike dukagjinase dhe me trashëgimi me tradita të padis-

kutueshme të të parëve.

Me çfarë mund të prezantoheni në gazetën "Dukagjini"?

Në gazetën "Dukagjini" mund të prezantohem me disa punime druri, si vegla muzikore, ikona, panorama e të tjera.



Duke qene djalë i Dukagjinit, i fshatit Gjuraj, i komunës apo i krahinës së Pultit, çfarë është për ju Gjuraj, Pulti dhe në tërësi Dukagjini?

Duke qene djalë i fshatit Gjuraj apo në tërësi i Dukagjinit, për mua fshati Gjuraj, ku kam lindur është një fshat me tradita shumë të lashta, si: trimërinë, besën dhe bujarinë, të cilat ne i trashëgojmë

edhe sot, si gjithë Pulti e Dukagjini në tërësi.

Në këtë mes, sa e ndjeni veten dukagjinase?

Në këtë mes e ndiejë veten patjetër dukagjinase dhe dua të mbetem gjithmonë bir i Dukagjinit, e sa të jetë e mundur ta meritojë këtë emër.

Kjo pune artistike që bëni është dhunti apo pasion, dhe kujt ja dedikoni?

Kjo pune artistike që bëj është edhe dhunti edhe pasion, edhe ia dedikoj babait tim, Pjetrit, i cili ka qene një punues i mire i veglave muzikore

Cili është objekti i kësaj pune, janë punime druri, apo punime të ndryshme, ikona, portrete apo çfarë tjetër?

Objekti i kësaj pune është që unë të punoj sa të jetë e mundur të kënaq sa më shumë artdashësit e mi me punime cilësore e sa më shumë artistikisht. Vetëm duke punuar me këtë synim, jo vetëm të kënaq artdashësit e mi, por dhe mund të gjeje sa më shumë blerës të tyre.

Cili është perspektiva e juaj?

Në radhe të pare kam pasion në këtë lloje arti, por edhe ofertat nuk më kane munguar, kam pasur shumë dhe vijnë të kem oferta brenda dhe jashtë vendit, si në hapësirën e Qarkut të Shkodrës, në Malësi të Madhe dhe në Mal të Zi.

Prandaj do të vijojë në këtë fushë, por do të bëj përpjekje të kemi një organizim tjetër, me kontrate oferte, sigurisht pa hequr dore nga pasioni i im i vijueshëm.

Merreni me hulumtime, me studime, apo dhe me meditime? Në qofte se po, mund të na i tregoni dhe ti publikojmë nëpërmjet gazetës "Dukagjini"?

Deri tani nuk jam marre me hulumtime apo studime të veçanta, por në qoftë se do të merrem, do ti publikojë në gazetën "Dukagjini". Në të njëjtën kohë, i bie çiftelisë, i këndoj asaj, këndoj kënge majakrahu dhe ju bie të gjitha veglave popullore të krahinës sonë, dhe kohet e fundit morëm pjesë në një festival në Tiranë, në të cilin morëm çmime nderi. Për këtë marre pjesë në grupim artistik "Dukagjini" Gjithashtu bëj përpjekje të meditojë! Nga njëherë shkruaj ndonjë varg, bëj përpjekje të hedh në letër ato që ndiejë. Të shohim, mund të arrije edhe të shkruajë e të botojë! T'ia lemë kohës.

Keni dëgjuar apo lexuar për gazetën "modeste" e pagëzuar me emrin "Dukagjini", çfarë mendoni për të dhe a e shikoni mundësinë të bëheni pjesë e saj?

Kam dëgjuar për gazetën tone të dashur "Dukagjini", madje e kam lexuar edhe disa artikuj të saj. Është një gazete modeste, është e pëlqyer shumë nga lexuesit jo vetëm dukagjinase, por edhe nga shumë të tjerë. Ajo, në përgjithësi

ka informacion të plote dhe të dokumentuar, çka bëhet më shumë e besueshme. Mendoj, pavarësisht nga vështirësitë që keni, duhet të ecni me këtë ritëm dhe me këtë objektivitet e paanësi.

Të është dhënë mundësia të njiheni me historinë e Shoqatës "Atdhetare-Dukagjini" dhe në qofte se po, çfarë mund të na sugjeroni, në veçanti në fushën e historisë, të kulturës, të artit apo në fusha të tjera? A e shikoni mundësinë të bëheni pjesë e saj dhe të kontribuoni për realizimin e misionit të saj?

Jam i njohur me Shoqatën "Atdhetare-Dukagjini", për punën që ka bërë dhe që vijon të bëjë, çka e ndiejmë veten mire. Unë, pavarësisht se jam i ri, por nuk di ndonjë organizim të ketë bërë kaq shumë për Dukagjinin e dukagjinastë sa ka bërë kjo organizate, për të cilën ju përgëzojë. Tani për tani, nuk mund t'u jap ndonjë sugjerim, por mendoj se duhet të ecni pa u ndalur në realizimin e misionit tuaj. Tani për tani nuk ju premtoj ndonjë gjë, por së shpejti mund të bëhem pjesë e saj.

I nderuari Gjok, ju falënderojmë që u bëtë pjesë e kësaj gazete, duke publikuar punën tuaj, jetën tuaj dhe për mendimet që paraqitet. Me këtë rast, ju urojmë punë të mbare dhe me faqe të bardhë!

Ju falemdierit, ju që më dhatë rastin të bëhem pjesë e juaj dhe të publikohem për jetën dhe punën që bëj. Respekt!

**Bashkëbiseduesi,
Ndue Sanaj**

Kryengritja e Kosovës e vitit 1910

Masat e ashpra xhonturke dhe ekspeditat ushtarake të Xhavit Pashës, që shtypën me egërsi lëvizjen e fshatarëve kundër taksave dhe kundër shërbimit ushtarak gjatë vitit 1909, i acaruan mjaft marrëdhëniet e shqiptarëve me xhonturqit. Rrethet patriotike dhe komitetet e fshehta i shtuan përpjekjet për organizimin e kryengritjes së armatosur kundër regjimit xhonturk. Një gjendje e padurueshme u krijua sidomos në Kosovë, ku në pranverë të vitit 1910 filloi të lidhej besa për të kundërshtuar me armë veprimet arbitrare të reaktionit xhon-turk. Në ditët e para të prillit fshatarët e rrethëve të Mitrovicës, të Vuçitërnës e të Llapit, sulmuan garnizonin osman të Prishtinës. Kryengritja u përhap menjëherë në krahinat e tjera të Vilajetit të Kosovës dhe në krahinat tjera shqiptare sidomos në ato të pollogut në Dibër, në Tetovë, dhe në Gostivar. Gjatë asaj periudhe Porta e Lartë shpalli shtettrëhimin dhe vendosi të organizonte një operacion të ri ushtarak në Kosovë, nën komandën e Shefqet Turgut Pashës, njërit prej gjen-eralëve më të shquar të saj. Nga mesi i prillit ai arriti në kryeqendrën e vilajetit të Kosovës në Shkup, me

një ushtri prej 16 mijë forcash turke. Ndërkohë kryengritësit morën masa për tu bërë ballë forcave të mëdha armike. Në kuvende të ndryshme u bë pajtimi i gjaqeve, u shpall mobilizimi i burrave të aftë për luftë dhe



u përpunua plani i veprimeve të armatosura. Një pjesë e kryengritësve, të udhëhequr nga Idriz Seferi, zunë Grykën e Kaçanikut nga do të sulmonin ushtrinë osmane, kurse pjesa tjetër e udhëhequr nga Isa Boletini u vendosën në Grykën e Carralevës.

Sulmi i parë i ushtrisë osmane filloi më 30 prill të vitit 1910

kundër Grykës së Kaçanikut, ku u zhvillua për dy ditë rresht një betejë e përgjakshme. Forcat kryengritëse të ndodhura përballë ushtrive superiore në numër dhe në armatime u detyruan të tërhiqeshin. Ndërsa

beteja e dytë e madhe u zhvillua në Grykën e Carralevës në fillim të majit dhe vazhdoi tri ditë. Porta e Lartë dërgoi në Kosovë forca të reja ushtarake, duke e ngritur numrin e përgjithshëm në rreth 40 mijë veta, të cilat u vunë nën komandën e vetë ministrit të Luftës, Mahmut Shefqet Pashës. Pas një qëndrese heroike edhe

mbrojtësit e Carralevës u tërhoqën.

Gjatë muajve maj-qershor, pas luftimeve të tjera të ashpra me kryengritësit, forcat osmane hynë në Prizren, në Gjakovë, dhe në Pejë. Pas rënies së kryengritjes në Kosovë, qeveria xhonturke, që synonte të godiste gjithë lëvizjen kombëtare, urdhëroi trupat e veta që ta vazhdonin operacionin edhe në krahinat e tjera. Gjatë kësaj marshimi në Shqipërinë e Veriut dhe në atë të Mesme, kudo u shpall shtettrëhimin, u bënë ndjekje e arrestime, u ngritën gjyqe ushtarake, u mbyllën klubet, shkollat dhe gazetat shqipe.

Kryengritja e Kosovës e vitit 1910, pati jehonë të gjerë në popullin shqiptar dhe jashtë saj. Kryengritja e Kosovës e vitit 1910, nuk pati përkrahjen e qarqeve politike të shteteve fqinje të cilat kishin pretendimet e tyre aneksioniste ndaj tokave shqiptare, gjithashtu edhe Fuqitë e Mëdha vijuan të përmbaheshin politikës, tashmë tradicionale të ruajtjes së status quo-së. Fuqitë e Mëdha i trajtuan ngjarjet në Shqipëri si një çështje thjesht e brendshme e Perandorisë Osmane dhe në këtë mënyrë i lanë dorë të lirë Stambollit. Veprimet e qeverisë së Stambollit për të shtypur kryengritjen shqiptare u përkrahën edhe nga Austro-

Hungaria e Rusia të cilat ndonëse kryesisht kishin qëllime të kundërta ishin të interesuara të mos kishte lëvizje revolucionare në Ballkan, dhe në këtë mënyrë ato ishin në favor të Perandorisë Osmane. Gjithashtu Fuqitë e Mëdha nën presionin rus ndërhynë pranë qeverisë turke për rivendosjen e qetësisë në vilajetin e Kosovës, pasi me kërkesat e tyre për autonomi kryengritësit shqiptarë prishnin planet e tyre për hegjemonizmin e sllavëve në Ballkan. Lufta e shqiptarëve në vitin 1910, ndonëse u kufizua pothuajse vetëm në vilajetin e Kosovës ku përfshihej edhe një pjesë e pollogut, kjo kryengritje ishte e para lëvizje e armatosur në fillim të shek. XX, por që mbeti në kufijtë e një vilajeti të vetëm lufta e armatosur e popullit shqiptar kundër sundimit osman, nuk arriti të shtrihej në një hapësirë të gjerë kombëtare as në rrafshin organizativ, as në atë politik e ushtarak, kjo luftë e shqiptarëve shkaktoi një tronditje të thellë në hapësirën e Ballkanit dhe tërhoqi pa dyshim vëmendjen e Fuqive të Mëdha për të zgjidhur çështjen shqiptare, megjithëse kryengritja e armatosur e vitit 1910 u shtyp, qeveria turke u detyrua të bëjë ndonjë lëshim ndaj shqiptarëve.

Nga Jeton AMETI

Malësia e Madhe "Nderi i Kombit"

- SIMPOZIUMI SHKENCOR "KOPLIKU
NË 100-VJETORIN E PAVARËSISË" -



Nga Kadri Ujka

Malësia e Madhe që do të tërhiqte vëmendjen e personaliteteve të shquara evropiane si treva e "sojit më të bukur të njerëzve në Ballkan, të qëndrueshëm ndaj të gjitha stuhive ("dyshek toke jastëk guri") sipas Doktor Milan Shufllait, "njerëz me temperament të nxehtë dhe të rrëmbyer" sipas Franc Nopçës, "të cilët edhe pse kanë afër 15 shekuj që e njohin krishterimin, doket e fisit i kanë më të forta se kanunin e kishës, sikur gruaja malësore u flet lirish burrave dhe nga shumë anë është më e lirë sesa ajo në Shkodër dhe Në Podgoricë" sipas sociologes dhe historianes Edith Durham, nuk kishte sesi të mos tërhiqte vëmendjen e Vetvetes, çka solli atë që sot na gëzon, nderon dhe lartëson të gjithëve: Malësia e Madhe në 100-Vjetorin e Shpalljes së Pavarësisë dhe Shtetit të Parë Shqiptar nderohet nga Presidenti i Republikës me titullin "Nderi i Kombit".

Jo për krenari provinciale apo të brendshme (se të jesh malësor s'është as meritë, as fatkeqësi), por mund të pohojmë me shumë dinjitet se Malësia e Madhe, trevë me një trashëgimi kulturore serioze, mjerisht, akoma e pastudiuar, vjen në 100-Vjetorin e Shpalljes së Pavarësisë dhe Shtetit të Parë Shqiptar si një trevë perlë në kuptimin e qytetarisë, historisë dhe të kulturës si vlera të spikatura të një civilizimi shumë të hershëm. Mjafton t'u referohemi kodeve të vetëqeverisjes në Malësinë e Madhe që në shek. XIII-XIV, të cilat, siç thotë Shufllaj, shquheshin nga ndikimi i dukshëm latin që kishin thithur. Kujtojmë se njëri nga këto kode qeveriseje si Kanuni i Kastratit u botua në 1891-in, ndryshe 44 vite para "Kanunit të Lekë Dukagjinit" të mbledhur nga Sh. Gjeçovi. Jo rastësisht Bogdani, malësorët, do t'i quante lisa, lisa të shpirtit për nga madhështia.

Jo rastësisht kjo trevë do të lindte e rriste lisa të tillë si Lukë Kaçaj "Nderi i Kombit", Sali Mani "Arist i merituar", Rrok Gjellaj, fitues i Çmimit "Naim Fra-

shëri i Artë", Jonuz Delaj, rapsodi lauréat i 6 festivaleve folklorike kombëtare, apo brilante të tillë të fjalës si Sokol Zekaj, "Pena e Argjendte" -2002, Gjekë Marinaj, "Pena e Artë"- 2003 nga Shoqata e Shkrimtareve Shqiptar të Amerikës, i cili arriti të hiqte nga tekstet mësimore të "Richland College", në Dallas të Teksasit, ku jep mësim, shkrimtarin më të madh të të gjitha kohërave, Nathaniel Hawthorne duke vendosur në atë program mësimor Ismail Kadarenë, Tonin Kaçaj (libri i "Thyerje kristali" botuar në Itali si pjesë e një antologjie kombëtare shqipe së bashku me romanin "Oh" të A. Pashkut e te tjerë). Nuk do të ishte aspak rastësore që në Specialen Kombëtare kushtuar 100-Vjetorit të lindjes së Migjenit dhe 80-Vjetorit të lindjes së Dritëro Agollit media e shkruar, krahas studimeve kritike të akademikëve Rexhep Qosja dhe Emil Lafe do të botonte edhe studimin kritik "Leximi aristotelian i veprës së Agollit" të kritikut malësor, Kadri Ujka. Në vazhdim le të kujtojmë poetet dhe prozatorët si: Dakë Keqaj, autor i disa vëllimeve poetike, Gëzim Vuçaj, poet fitues i Çmimit II "Horoskopi-2008" të lexuesit, në konkursin vjetor kushtuar 14 Shkurtit, "Ditës së të Dashuruarve", Fitore Jonuzi, poete dhe prozatore për fëmijë, Mimoza Rexhvelaj, poete me ambicie të qartë, Life Hasaj, Nikolin Narkaj, Fatbardha Sokoli, Mehdi Duli, fabulist, Shyqyri Dushaj, poeti që me poezinë kushtuar princshës Dajana të Uellsit meritoi mirënjohjen e familja së Saj, Isuf Hebjaj, autor i disa vëllimeve poetike, tregimtari Syrja Smajlaj, shkrimtari Qazim Çela, njëri ndër malësorët që kontribuon me komeditë e veta në Teatrin "Migjeni", krahas kontributit si anëtar i grupi humoristik "Gaz dhe maraz" romancierin e mirënjohur, nga më prodhimtarët prej disa dekadash si dhe përkthyes i disa autorëve nga letërsia botërore, Ramiz Lika, ish-kryetar i LSHA të rrethit tonë, Pjetër Vukaj, poet, prozator dhe mjeshtër gdhendjeje në dru dhe në lëkurë, të cilat kanë pasur promovime të suksesshme në ekspozita të ndryshme, brenda dhe jashtë Shqipërisë.

Arritje në fushën e vlerave kulturore ka qenë botimi i librit "Malësia dhe fiset e saj" në dy pjesë nga Profesor Lulash Palushaj (SHBA), i pari i këtij lloji për trevën tonë, si dhe librat "Malësia e Madhe si e njoha unë" i prozatorit Nikolla Spathari, aktualisht kryetar i LSHA, Durrës dhe libri "Brezni të Kelmendit" i Gjovalin Gjellaj, i cili dëshmojnë dëshirën e zjarrtë të malësorëve, veçmas tek diasporës e saj në Amerikë për të shkruar dhe nderuar historinë e tyre.

Kështu mund të nderojmë me këtë rast veprimtarinë kulturore dhe artistike në pjesën e Malësisë përtej kufirit politik shtetëror në vite si ato të F. Camajt, Nol Berishës, Preng Ulit, Preng Grudës, Ndue

Sinishtaj, Zef dhe Anton Gjellaj, Lulash Palushaj, Rrok Gjellaj, Rrok Berisha, si dhe kontributi i shoqatës patriotike-kulturore "Tringa e Grudës" në drejtimin e poetit Rrok Gjellaj.

Në Madhe e Madhe aktualisht lëvrohen thujtë të gjitha gjinitë letrare: Proza, poezia, dramatika, sikurse edhe kritika letrare, një risi që spikat si një rast unik në të gjithë Veriun e Shqipërisë, me kontribute serioze kushtuar krijimtarisë së shkrimtarëve dhe artistëve malësorë, po aq me studimet mbi krijimtarinë: e Migjenit, Kadarsës, Agollit, L. Kaçajt, F. Krajës, V. Allmuajt, B. Zllamit e te tjerë, shoqëruar me vlerësime serioze në promovime, takime dhe në mediat: tona sa të shkruara, sa elektronike.

Malësorët tanë "jashtëzakonisht të frytshëm, me vitalitet të jashtëzakonshëm individësh" siç shprehej historiani i shquar kroat, Dr. Shufllaj, jo vetëm kanë spikatur me fjalën e tyre në veprimtari serioze brenda e jashtë vendit si: Sokol Zekaj, poet, në konkurse kombëtare në fushën e poezisë, në veprimtarinë letrare si "Dita e Poezisë, në Durrës, Kadri Ujkaj, si kritik letrar dhe studiues, në veprimtari të tilla si: "Seminari shkencor Ndërkombëtar "Shkodra në Shekuj", konkursi kombëtar në fushën e kritikës letrare për nder të 75-Vjetorit të Ditëlindjes së Dritëro Agollit", në veprimtaritë madhore historike si "17-24 Shkurt 2008-Java e Pavarësisë së Kosovës" së bashku me operatorin e talentuar Rifat Ymeri, sikurse kumtimet në simpoziumin "600 Vjetori i Lindjes së Heroit tonë Kombëtar- Gjergj Kastrioti", së bashku me publicistin Ndue Bacaj, në Mal të Zi. E te tjerë, e te tjerë, veprimtari që janë përcjellë me një vëmendje dhe respekt nga audienca të kualifikuara në Shqipëri, Mal të Zi, Kosovë.

Malësia e Madhe do të ishte lokomotiva e fituesve të Festivaleve Folklorike Kombëtare, filluar nga Festivali i Parë, 26 qershor 1966 në Elbasan ku kupën e këtij festivali do ta fitonte Grupi i 25 çiftelive të Koplikut të Sipërm, nën drejtimin e Anton Gjekës. Një shkallë të tillë suksesi artistët malësorë do ta korrnin edhe në Festivalin Folklorik Kombëtar të Beratit në vitin 1995 sikurse tejet serioz në pasurimin e veprimtarive shkencore në nivel rrethi do të ishte organizimi i Simpoziumit "Malësia e Madhe-një visar shqiptarie", 23-24 shtator 1996, nën kujdesin e kryetarit të Bashkisë Koplik, Perlat Rammaj si dhe simpoziumi shkencor kushtuar Luftës së Koplikut të 1920-ës, me rastin e 89-vjetorit të saj, më 5 tetor 2009, nën kujdesin e kryetarit të Bashkisë Koplik, Ramadan Lika.

Nuk ka festival kombëtar, ku të mos kenë debutuar me sukses duke zënë edhe vende kryesuese të parë, të dytë apo të tretë: Rrok Gjellaj vjen në këtë jubile si themelues dhe drejtues i Ansambli folklorik "Ku e muer emrin Malësia" me rastin e 100 Vjetorit të Ngritjes së Flamurit në Deçiq, kurse Jonuz Delaj, rapsod, i dekoruar nga Presidiumi i Kuvendit Popullor-1978 me Urdhërin "Naim Frashri kl. III", si fitues i Kupës së Festivalit Folklorik Rajonal zhvilluar në Lezhë, në vitin 2007.

Po kështu në kuadrin e këtij Jubileu

meriton të nderohen Grupi i 7 lahutarëve malësorë dhe në veçanti vëllezërit Zeka, nga Kalldrini, fitues i Kupës së Festivalit Folklorik Kombëtar, Gjirokastër, 1988, me Vallën e t' Lekajve.

Askush nuk mund të mos vlerësojë në këtë 100 Vjetor të jetës sonë kulturore kolosin e belkantos shqiptare Lukë Kaçajn "Nderi i Kombit", "me emrin e të cilit do të krenohen ndër vite muret e Konservatorit "Bajkovski" të Moskës" do të shprehej për Shaljaminin tonë, në qershor 1955, kryetari i komisionit të jurisë së këtij konservatori, bashkëkohësi i Shaljaminit të madh,, gjenit të muzikës ruse, 80-vjeçari Bësejvi.

Për hir të së vërtetës, përballë frymës së harresës, pas viteve 90-të ndaj vlerave të tilla të kulturës kombëtare si Lukë Kaçaj nuk mungoi as sensibilizimi i pandërprerë i kritikës sonë letrare dhe vetë LSHA -M. Madhe në të gjitha mediumet brenda dhe jashtë Shqipërisë deri në SHBA për dhënien e këtij titulli që na nderon të gjithëve, derisa personalisht pata kënaqësinë dhe privilegjin moral të jemi i ftuar në protokollin e dhënies së titullit "Nderi i Kombit" madhështorit Lukë Kaçaj. Si njëri ndër gazetarët më të vjetër, aktualisht anëtar i Unionit të Gazetarëve Profesionistë të Veriut dhe zv. kryetar për degën M. Madhe nuk mund të mos vë në dukje kontributin e nderuar sa intelektualist, sa trimërisht të gazetarëve malësorë dhe pronarët e tyre të cilët këto 22 vite tranzicion tejet të vështirë investuam aq shumë dhe vazhdojnë të mbajnë në këmbë mediat private të shkruara apo vizive, të vetmet në Shkodrën 2400 vjeçare, në Malësi të Madhe dhe Mal të Zi, siç janë gazetatat: "Shqipëria Etnike", "Malësia", "Koha javore", dhe televizionet lokale: "Malësia", "Kopliku", në M. Madhe, "Rozafa", "Antena Nord" (Shkodër) dhe "TV-Boin" Tuz (Mali i Zi). Dhe befasia e mrekullisë malësore si kurë ndonjëherë tjetër më kujton thënie brilante dhe profetike të Konicës së madh, babait të kritikës letrare shqiptare: "Shqiptarët veç e veç bëjnë mrekulli...". A mund të mos nderohet në këtë përvjetor krenarie dhe dinjiteti etnografi malësor nga Lekajt e Smalj Martinit dhe Tringë Smajles, Tuz, Mali i Zi, Shtjefen Ivezajt, drejtorit të Muzeut të Parë Etnografik në Malësi, Shtjefen Gjeçovit të ditëve tona?. Dhe si do të thoni ju? Me një vullnet të hekurt prej rilindësi modern që kërkon të mbajë traditën tonë kulturore-etnografike përballë riskut të asimilimit në epokën e globalizmit për kombet e vegjël si yni, duke vënë në dispozicion mjedisin më jetik dhe intim të njeriut, siç është streha familjare, shtëpia.

Ja pra, pse kjo trevë fjalëgjetur, zemërhapur dhe pushkëngritur në emër të dinjitetit kombëtar e kishte bërë hak nderimin: "Nderi i Kombit" që iu dha sot nga Presidenti i Republikës, Bujar Nishani në 100-Vjetorin e Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë nga burri i shtetit, diplomati i rangut evropian, "Babai i Kombit Shqiptar", Ismail Qemali, bashkëluftëtari i "Heroit të Popullit", simbolit të krenarisë së Malësisë së Madhe ndër shekuj, Dedë Gjo' Lulit.

Nënë Tereza u përjetësua në Montreal, Kanada

NË KUADRIN E 100-VJETORIT TË SHPALLJES SË PAVARËSISË, NË MONTREAL, KANADA U PËRURUA SHTATORJA E NËNË TEREZËS. MORI PJESË EDHE AMBASADORJA E SHQIPËRISË NË KANADA, ELIDA PETOSHATI DHE PERSONALITETE VENDASE

Ditën e shtunë, në datën 24 nëntor 2012, në një të ftohtë që nuk është i papritur në këtë periudhë të vitit në Montreal, në kuadrin e 100-vjetorit të Pavarësisë Kombëtare, u përurua shtatorja e bamirëses së shquar shqiptare, Nënë Tereza. Në këtë ngjarje të shënuar për shqiptarët e Montrealit dhe rrethinave ishte e pranishme Ambasadorja e Shqipërisë në Kanada, Shkëlqesia e Saj, Elida Petoshati, Kryetari i bashkësisë së Jug-Perëndimit Benoit Dorais, kryepeshkopi i Montrealit imzot Christian Lépine, deputetja e parlamentit federal (kanadez), Hélène LeBlanc, këshilltarë bashkiak e te tjerë. Përveç shqiptarëve nga Montreali dhe rrethinat, në ceremoni kishin ardhur edhe shqiptar nga Ottawa dhe Toronto ku binte një sy përfaqësuesit e misionit shqiptar "E Lumja Nënë Tereza" Toronto me në krye Gjergj Nikolla.

Në ceremoninë e organizuar me këtë rast, foli kryetari i bashkisë së Jug-Perëndimit të Montrealit, Benoit Dorais, i cili pasi përshëndeti të pranishmit në gjuhën e shumicës pjesëmarrëse, nxori në pah vlerat e figurës së Nënë Terezës, atë entuziazëm që shkaktoi kërkesa për ngritjen e një shtatoreje të Nënë Terezës nga ana e Bashkësisë shqiptare të Kebekut në Montreal, tek të zgjedhurit e bashkisë së Jug-Perëndimit në Montreal. Ai foli për historinë e nobelistes së madhe shqiptare dhe rëndësinë që kanë për Montrealin, integrimi i shqiptarëve ashtu si dhe i komuniteteve të tjera që jetojnë këtu.

Deputetja e parlamentit federal, Hélène LeBlanc veç të tjerash citoi fjalët e Nënë Terezës në ceremoninë e marrjes së çmimit Nobël, ku ajo shprehet se nga gjaku është shqiptare. Ajo gjithashtu theksoi se kjo shtatore shërben për forcimin e lidhjeve mes shqiptarëve që jetojnë këtu dhe Kanadasë, vendit që i ka pritur.

Kryepeshkopi i Montrealit, Imzot Christian Lépine në ndërhyrjen e tij të shkurtër citoi fjalë të Nënë Terezës që edhe në këtë të ftohtë, të ngrohin. Ai kujtoi se Nënë Tereza n'a kërkonte t'i buzëqeshim edhe atij që nuk kemi dëshirë t'i buzëqeshim.

Fjala e Elida Petoshati shkaktoi entuziazëm tek të pranishmit. Ajo sigurisht që solli përshëndetjet e qeverisë shqiptare dhe falënderoi të gjithë shqiptarët e Montrealit dhe ata që ndihmuan në ngritjen e shtatores së Nënë Terezës, këtij simboli bashkues të shqiptarëve.

Ajo falënderoi veçanërisht, Kujtim Ismaili dhe gjithë bashkësinë e Shqiptarëve të Montrealit për këmbnguljen në realizimin e kësaj veprë që do të shërbejë për të forcur lidhjet me komuniteteve tona kudo në Kanada me vendin e tyre pritis. Ajo u shpreh se ky vit është shpallur viti i Shqipërisë këtu në Kanada dhe se zbulimi i shtatores së Nënë Terezës është një nga kulmet e aktiviteteve tona në këtë kuadër, Petoshati u shpreh në dy gjuhët zyrtare të Kanadasë si dhe në gjuhën tonë shqipe.

Kryetari Bashkësisë Shqiptare të Kebekut në Montreal, Kujtim Ismaili, në fjalën



e tij theksoi rëndësinë e figurës së Nënë Terezës për të gjithë shqiptarët dhe mesazhin që ajo n'a përcjell, paqe, dashuri dhe respekt. Ai falënderoi të gjithë anëtarët e bashkësisë shqiptare këtu në Montreal dhe veçanërisht ata që ndihmuan më shumë në realizimin e këtij aksioni siç ishte ai i ngritjes së shtatores së Nënë Terezës këtu në Montreal. Kjo dhuratë, vepër e skulptorit Benard Lekgegaj të cilin fatkeqësisht nuk e kemi prezent do të kontribuoj në forcimin e lidhjeve midis komunitetit tonë dhe banorëve të

Kryetari i Bashkësisë Shqiptare të

Kebekur në Montreal, Kujtim Ismaili, i dhuroi Benoit Dorais çmimin e 100 vjetorit të Pavarësisë të shoqëruar nga një skulpturë të figurës qendrore të shpalljes së Pavarësisë, Ismail Qemalit, çmim i dhënë nga Albanian Life Quality Union.

Nga ana e tij, Kryetari i Bashkësisë së Jug-Perëndimit të Montrealit, Benoit Dorais, u dhuroi nga një libër turistik të monibashkisë së Sud-Ouest (jug-Perëndimit), Petoshati dhe, Kujtim Ismaili.

Pastaj u kalua në momentin e shumë pritur, zbulimin e shtatores së Nënë Terezës. Shiritin e preu kryetari i Bashkësisë Shqiptare të Kebekut në Montreal, Kujtim Ismaili si dhe kryetari i Bashkësisë së Sud-Ouest-it të Montrealit Benoit Dorais. Në momentin e zbulimit të shtatores, flamuj kuq e zi dhe flamuj të Kosovës, Kanadasë e Kebekut valëviteshin në sfond duke e bërë atmosferën festive duke sfiduar të ftohtin polar të asaj dite.

Në zbulimin e shtatores së Nënë Terezës ishin të pranishme mediat vendase, frankofone dhe anglofone si dhe përfaqësuesi i televizionit shqiptar Pasqyra në Toronto Ilir Lena.

Pas zbulimit të shtatores u procedua me foto-kujtime të të pranishmëve pranë shtatores së Nënë Terezës.

Më pas u bë bekimi i statujës nga Don Xhovani i Misionit Shqiptar "E Lumja Nënë Tereza", Nga

Nga Ajet Nuro

SOT, FESTË TË MADHE KA SHQIPËRIA-100 VJET PAVARËSI 1912-2012

Ngjarjet më të rëndësishme historike që përgatiten kushtet për të çuar në 100-vjetorin e Shpalljes përfundimtare të Pavarësisë me 28 nëntor 1912, kane qene vendimet historike të Memorandumit të Greçes dhe lufta e madhe që bëri Populli i Malësisë së Madhe të mbështeture edhe nga krahina të tjera shqiptare në vitet 1910-1911, e cila u kurorëzua me ngritjen e Flamurit Shqiptar, për të parën herë në majën e Deçitit nga Dede Gjon Luli, Nike Leke Pepaj e të tjerë.

Kuvendi, apo Memorandum i Greçes, u mblodhe nga data 10-23 qershor 1911, në vendin e quajtur Greçe, i cili ndodhet në afërsi të fshatit Selce të Kelmendit. Në këtë ngjarje shume të rëndësishme historike, e cila pak më vonë do të mundësonte Pavarësinë e Shqipërisë.

Në këtë kuvend morën pjesë 34 përfaqësues nga populli, patriot, të zgjuar, e trima, prej të cilëve shumica e tyre ishin udhëheqës të luftës kundër turqve, dhe anëtare të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, e të tjerë, pari të krahinave e fshatrave të ndryshme, kryetar të djelmnive, intelektual dhe klerikë.

Këta përfaqësuesin krahina apo zona, në veçanti të Veriut, por dhe mbare shqiptare, të cilët ishin: Dede Gjon Luli-Hoti, simboli i kryengritjes të viteve 1910-1911; Nike Leke Pepaj-Selce, anëtar i Lidhjes Shqiptare te

Prizrenit dhe komandant i kësaj Lidhje për Malësinë e Madhe, i cili udhëhoqi luftërat kundër osmanëve dhe kundër serbëve e malazezeve për mbrojtjen e tokave shqiptare; Dede Nika, kryeparia i Grudës; Cal Nika-Selca, Lul Rapuka-Vukel; Llesh Gjergji-kryeparia i Kastratit; Galo Smajli-Tripsh, i cili i ngarkuar me disa të tjerë për sigurinë e pjesëmarrësve të Kuvendit të Greçes; Tome Nika-Shkrel; Sokol Bacì-Grude; Gjeto Marku-Hoti; Mehmet Shpendi-Shale; Martin Preka-Shkrel; Prele Marjani-kryeparia i Shalës; Avdi Kola-kryeparia e Gimajve; Nike Mhilli-Shllak; Gjon Gjeka-Tripsh; Tringa Smajlja, bija e kryeparisë së Grudës; Bec Delija-kryeparia i Nikajve-Merture; Dash Bajrami-Nikaj-Merture; Pup Çuni-Toplana; Binak Lulashi-kryeparia i Shoshit; Prele Gjetja-përfaqësues i mbare Kelmendit; Muçi Pepo; Luigj Gurakuqi-patriot dhe trim i madh, intelektual i kompletuar, pjesëmarrës i sa tubimeve, anëtar i Komitetit të Podgoricës dhe fytyra qendrore e organizimit të ngritjes së Flamurit në Vlore, me 28 nëntor 1912. U vra tradhtisht nga Ahmet Zogu në Bari të Italisë; Hile Mosi, patriot, intelektual i shquar; Sali Hoxhe Hidri-Elbasan, përfaqësues i Ismail Qemalit; Risto Siliqi-patriot, intelektual i shquar, shkrimtar e poet; Nikolla Lako-përfaqësues i patriotëve te Korçës; Pater Karl Prenushi-famullitar i Vuksanlekajve; Lorenc Mitrovic-famullitar i Bajzës; Sebastjan Hila-famullitar i Rapshe; Luigj Bushati-famullitar i Traboinit.

Këta trima, patriot të zgjuar, intelektual të përkushtuar, prezantuar në zjarrin e kry-

engritjes së Malësisë së Madhe anti-osmane dhe kundër Fuqive të Mëdha për pushtimin e tokave shqiptare nga ana e serbo-malazezeve, ishin pjesëmarrës të Memorandumit të Greçes dhe së bashku me përfaqësuesit e tjerë nga krahinat mbare shqiptare që ishin prezent në këtë mbledhje historike të Greçes, formuluan 12 kërkesat madhore, të cilat u njohën me emrin "Memorandum i Greçes", ose "Librit të Kuq", që kishin në themel Lirinë, ngritjen e Flamurit mbar shqiptar dhe Pavarësinë e Popullit Shqiptar njëherë e përgjithmonë.

Memorandum i drejtohej Qeverisë Xhonturke me kërkesën për të krijuar një provincë autonome shqiptare. Memorandumit, ose Libri i Kuq, siç u quajti në atë kohë, me titull "Memorandum mbi vendimet e dhëna prej Kuvendit të Përgjithshëm të Krerëve Shqiptar", mblodhur në Greçe të Selces së Kelmendit, me 10-23 qershor 1911, si përgjigje të proklamacionit të Shefqet Dergut Pashës, është fjala për shpalljen e amnistisë së përgjithshme që beri komandanti osmani operacionit kundër kryengritjes shqiptare, me 17 qershor 1911.

Memorandum i dorëzua përfaqësuesit të Turqisë dhe përfaqësuesit të Fuqive të Mëdha, në Cetine të Malit të Zi. Në fund të vendimit theksohet se, neve nuk do të pranojmë as një marrëveshje me Turqinë, pa dhënë të drejtat tona, që i kemi shprehur në 12 pikat e Memorandumit.

Ngritja e Flamurit Shqiptar, me 28 nëntor 1912, u arrit si rezultat i luftërave heroike të

popullit edhe pas vdekjes së Kryetrimt Legjendar, Gjergj Kastrioti. Si përfundim, mund të përmendim kryengritjet e Malësisë së Madhe dhe në përgjithësi zonat e Veriut me forcat Osmane dhe me ato serbo-malazeze deri në ngritjen e Flamurit të Pare në Deçit.

Gjate muajve shtator, tetor dhe deri në prag të Shpalljes së Pavarësisë, vijuan luftërat e pandërprera kundër ushtrisë osmane në Shqipërinë e Mesme e të Jugut. Gjate 12 ditëve deri me 28 nëntor 1912, u ngrit flamuri në Elbasan, në Korçe, në Durrës, në Gjirokastrë e të tjera vende të Shqipërisë. Në Vlore, me 28 nëntor, Ismail Qemali dhe Luigj Gurakuqi, në mes të shume delegateve të ardhur nga Shqipëria dhe Kosova, bene të mundur ngritjen e Flamurit Shqiptar në Vlore dhe Shpalljen e Pavarësisë.

Kjo ndodhi plote njëqind vjet më parë. Kjo ishte vepra më e madhe historike që, nga koha e Heroit tone Nacional, Gjergj Kastrioti. Le të shpresojmë se kjo dite e madhe historike ta bashkojnë popullin shqiptar brenda e jashtë vendit, duke lenë mënjane merite, apo mosmarrëveshjet politike majtas e djathtas, dhe të respektojmë qindra e mijëra shqiptare, të cilët të bashkuar si një trup i vetëm e vaditen me gjakun e tyre token amtare në shekuj që nga koha e Gjergj Kastriotit e deri në ditën e Shpalljes së Pavarësisë.

Rroftë 100 vjetori i Shpalljes së Pavarësisë! Lavdi atyre trimave që ranë në front të luftës, me flamur në grykë të pushkës ...!

Nga Nike Bunjaj, shkrimtar

100 Vite Pavarësi-100 Vite drejt së Ardhmes

Shoqata Atdhetare Dukagjini në vazhdim të punës saj për promovimin e vlerave dukagjinase dhe në kuadrin e 100 Vjetorit të Pavarësisë në bashkëpunim me Shoqin "Iliricum" dhe Famullin e të Lumes Nënë Tereza nga Hoti i ri ka organizuar, koncertin festiv të titulluar "10 Vite Pavarësi-100 Vite drejt së Ardhmes" më datën 26 Nëntor 2012 ora 18.00. në teatrin "Iliricum"-Shkodër. Duke u nisur nga titulli i tij, ky koncert ju besua nga grupi organizator fëmijëve dhe të rinjve dukagjinase. Ja vlen të përmendim gatishmërinë dhe kontributin që dhanë në organizimin e tij, drejtuesi i shoqërisë "Iliricum" Angjelin Deda, famullitari i Hotit të ri P. Luigi Canatto dhe Mt. Diana Marku. Bashkëpunimi dhe dëshira për të dhuruar një festë të bukur për 100 Vjetorin e Pavarësisë ishin dhe themelet e suksesit të këtij koncerti, i cili u hap me vargjet e At. Gjergj Fishtës:

*"Derisa t mundem me ligjërue
E sa gjallë me frymë unë jam,
Kurrë, Shqipni, s kam me t harrue,
Edhe n vorr me t përmendë kam".*

Pastaj në interpretimin e të rinjve të talentuar vëlla dhe motër Serxho e Jozefina Guri, të gjithë kënduam Himinin e Flamurit. Mirë se ardhja ju dhurua të pranishmëve nga prezantueset e talentuara Laura Plishta dhe Diana Bungu. Interpretimet ishin edhe një stafet që kalonte nga një brez tek tjetri. Aktori Tomas Delia solli me mjeshtri dhe plot emocion poezinë e At Bernardin Palajt "Kuç e zi" dhe menjëherë stafetën e merr brezi i ri me një poezi të Prel Milanit të interpretuar nga e reja Noela Pjerza. Interpretimet sollën duartrokitjet e vazhdueshme në sallë. Sa bukur kur në skenë sjellin emocion të gjithë së bashku duke ja nisur nga vrapimet me plot cicërima të fëmijëve 5 vjeçar të kopshiti "Nëna Fraciska" të Hotit të Ri dhe të rinjve të shoqërisë "iliricum", të cilët krenar për origjinën e tyre dukagjinase sollën melodinë e ëmbël të këngës popullore shkodrane dhe të muzikës së lehtë. Përmendim këtu interpretimet Jozefiana Guri, Arben Mjetës dhe Florida Shtylla. E nuk mund të kuptohet një eveniment artistik i shoqatës "Atdhetare-Dukagjini" pa kontributin e grupit të valles, i cili drejtohet nga koreografi Alfo Nika. Një interpretim me plot emocion solli Fran Valentini, i cili kërkesës sonë për bashkëpunim ju përgjigj me kënaqësi. Pas një punë intensive për vënien me sukses në skenë të dramës "Shtat Shaljanët", sollën për të pranishmit apelin që At Gjergj Fishta ju bënë shqiptarëve nëpërmjet vjershës "28 Nenduer 1913" të rinjtë Geg Shpati, Emiljan Palali dhe Albert Marku. Me njëherë, për të mbështetur At Gjergjin, fëmijët e famullisë së Hotit të Ri sollën inskenimin të titulluar "Nënë Shqipni", ku ata e sollën mesazhin e tyre mjaftë të fortë në lidhje me realitetin e Shqipërisë sot.

Kryesia e Shoqatës "Atdhetare-Dukagjini", në kuadrin e 100 vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë, me propozim të seksionit të veprimtarive të shoqatës,

vlerësojë kontributin e dukagjinase në shekuj në luftën e përpjekjet për Liri e Pavarësi, për të cilën ndjejmë krenari të ligjshme. Në mes të tyre, të nderojë me titullin "Anëtar Nderi" pas vdekjes për kontributin e "gjeneralit" Popullor, **Mehmet Shpendin**, me motivacion: "Me veprën e tij, prej një patrioti, luftëtari dhe udhëheqësi popullor për 42 vjet me arme në dore, ka dhënë një kontribut të shquar, për lirinë dhe pavarësinë e trojeve shqiptare deri në Shpalljen e Pavarësisë". Te nderojë me titullin "Mirënjohja" e shoqatës "Atdhetare-Dukagjini" "7 shaljanet", **Ndre Pepa, Vate Nika, Çun Luci, Ndre Koltona, Deli Pjetra, Hasan Pepa e Marash Pali**, me motivacion: "Akt i pashembullt i urrejtjes ndaj pushtuesit osman, simbol i bashkëveprimit dhe besnikërisë midis njeri-tjetrit në lufte për mbrojtjen e identitetit tone. Dhanë jetën në lufte "trojane" në Kështjellën e Shko-



drës kundër **Vezir Pashës**"; **Marash Tuci** nga Shoshi, me motivacion: "Luftëtarë i shquar përkrah mirditoreve dhe Karamahmut Bushatliut në luftën antiosmane në Kështjellën e Shkodrës në vitin 1878. U flijua në emër të besës se dhëne duke u kthyer kështu në një "konstadin" dukagjinase"; **Sokol Tona** nga Shoshi, me motivacion: "Pjesëmarrës aktiv në kryengritjet e viteve 1840, 1860 e 1862. Flake e ndezur e patriotizmit. Flijuar në kulle të barotit përkrah të **Oso Kukës**"; **Pal Gjoka**, me motivacion: "Rebeli i papërmbajtshëm antiosman. Biri i maleve legjendare të Shoshit. Vrau Bylykbashin e Shkodrës, Sulejman Age Hotin bashke me truporjën e tij. Mit i trimërisë malësore"; **Zeke Jakini** nga Shoshi, me motivacion: "Kaçaku i maleve shqiptare, që nuk bëri ujdi me asnjë pushtues. "Robin Hudi" shqiptar, në të cilin shëmbëllet gjithë madhështia e trimave që ka nxjerre kjo tokë Arbënore"; **Bush Delija** nga Shoshi, me motivacion: "Organizatori i grupit të vullnetareve të Dukagjinit në lufte përkrah vëllezërve malësorë në kryengritjet antiosmane të viteve 1910-1912. Ra si shqiponja në balë të betejës duke u bere burim frymëzimi e qëndrese për shokët e tij kryengritës";

Kole Gjoni nga Plani, me motivacion: "Njeriu i vlerave të larta atdhetare, i padurueshëm ndaj çdo lloj armiku, sakrifikoi jetën në një akt sublim për mbrojtjen e tokës nëne dhe nderit të atdheut ndaj pushtuesit osman"; **Preke Gjoni, Marash Kola, Lek Ndou** nga Kiri e **Gjelosh Uka** nga Mgulla, të rënë në luftën për ngritjen e Flamurit në Deçiq, me motivacion: "Kreshnik dukagjinase, që ra heroikisht në luftën antiosmane në Deçiq, në kuadrin e ngritjes së Flamurit, me gjashtë prill 1911. Me gjakun e tyre skuqen Flamurin e Gjergj Kastriotit, për të mbetur përherë në sfondin e lavdisë nacionale"; **Xhur (Gjon) Kola** nga Gimajt, me motivacion: "Simbol i barutit të ndezur kur cenohej nderi i çdo shqiptari. Atdhetari që nuk pranoi të jepte të dhjetat Perandorisë Osmane në pazarin e qytetit të Shkodrës. Atentatori i flakët që vrau Zenel Agen në shenjë mosnënshtrimit ndaj pushtuesit osman"; **Marash Uka e Gjelo Kiri**, nga Kiri, me motivacion: "Kaçak dhe rebel i betuar dukagjinase, një jetë të tërë e kaluar në prehrin e tokës nënë, në luftë të pa kompromis kundër hordhive osmane. U flijuan në emër të atdheut, për të mbetur

onjve nuk u paraqiten të merrnin titujt përkatës. Lind pyetja!? Ku jemi!? Çfarë po bëjmë!? Po, kryetaret e komunave ku janë? Pse te mos ishin pjese e këtij evenimenti? E theksojmë ketë se, edhe në raste të tjera nuk po marrin pjese në veprimtaritë e shoqatës "Atdhetare-Dukagjini"?! Mire se, vete nuk organizuan e zhvilluan ndo një veprimtari në kuadrin e 100 vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë, do të ishte e mire, që të ishin pjese e kësaj veprimtarie.

A mos vallë kemi rënë kaq poshtë që të mos jemi mirënjohës edhe atyre që dhanë jetën për lirinë që ne gëzojm sot!? Këta njerëz nuk ishin ne amerikane apo anglez. Jo, jo ata ishin gjyshërit tanë. Ata dhanë jetë, gjënë më të shtrejtë. E ne sot, nuk ngrihem nga vendi për të respektuar jetën e tyre. Emrat e tyre janë shënuar në librin e shenjtë të historisë së Nacionalitetit Shqiptarë. Po ju pyeteni vetën se, a do shënohet emri juaj. A jemi duke ecur kështu në shëmbullin e tyre!!!!

I falënderojmë të gjithë ata persona, që u morën me evidentimin e këtyre heronjë dhe ashtu siç u theksua edhe në sallë nga familjarët e heronjve, të cilët i morën

këto tituj një falënderim i veçantë për Shoqatën "Atdhetare-Dukagjini, e cila me këmbëngulje po punon në këtë drejtim.

Në përfundim, falënderojmë ata që e mbështetën financiarisht këtë aktivitet zotëri Fredi Gjuraraj, Lulash Gjeloshi, Ndue Mici, Nikolin Shqau. Një falënderim për grupin e punës që e realizuan këtë koncert, Alek Dushi, Angjelin Deda, Lulash Brigja, Prek Mrishën, Mt. Diana Marku. Dukate Bregu dhe Roza Pjetrin.

Gëzuar 100 vjetorin e Shpalljes së Pavarë-

sisë! Mbare dukagjinase, mbare popullit shqiptar i urojme fillim të mbare në 100 vjetorin e dytë të Shpalljes së Pavarësisë! "Asgjë nuk është e vetme! Hapësirës që jetojmë të gjithë gjallesat, nuk do ti thoshin "Gjithësia", në qoftë se gjithë përbërësit e saj nuk do të ishin bashke. Ata jo vetëm që janë bashke, por janë edhe në unitet njëra me tjetrën dhe i shërbejnë njëra-tjetrës në mënyrë të ndërsjelle, secili në peshën e vet", thekson një shkrimtar francez. Urojme ta kuptojmë kështu bashkësinë ku jemi lindur e jemi rritur apo kemi origjinën, nuk do të kishte kuptim të jete ndryshe nga ajo e përgjithshme. Prandaj, duhet kuptuar se secili zë një vend të caktuar në një hapësirë të caktuar, në të cilin formohet, ndjenë përgjegjësi dhe jep një kontribut të caktuar. Edhe komunitetit dukagjinase, ka kontributin e vet të diskutueshëm në historinë e krahinës, në historinë e Dukagjinit, në historinë e Shqipërisë, dhe e tilla të jete edhe në të ardhmen.

Nga **DANIELA PJETRI**

DUKAGJINI E DUKAGJINASIT

Dukagjini dhe dukagjinasi janë të hershëm në histori si emër dhe si princa. Emri Dukagjin përmendet që në fund të shekullit të VII, sipas testamentit të Gjon Buzukut të vitit 1510. Ai e çon burimin e Dukagjinave deri në Trojë. Luftuan në Bosnje-Hercegovinë, ardhur e vendosur në Arbëri nga Franca (axhuinët)

Emri Dukagjin rrjedh prej emrit të të parit të një dinastie princore, Gjin Tanushi, i cili në vitin 1281, fitoj titullin e lartë "Duke". Nga Dukagjini, morën mbiemrin pasardhësit e tij. Dhe territoret që sundoheshin prej kësaj familje morën emrin Dukagjin, kurse banorët u quajtën dukagjinasi. Emri i Dukagjinave lidhet me drejtimin e forcave ushtarake arbërore kundër turqve. Lufta kundër Turqve zgjati me shekuj. Por kurrë nuk ju nënshtruan dhe kurrë nuk arriti ti pushtonte. Siç thuhet se pa "Dukagjinin Shkodra do të fliste osmanisht, sot e gjithë ditën e lume".

Dukagjini përbëhet nga Shala, Shoshi, Toplana, Plani, Xhani, Kiri, Dushmani, Shllaku dhe Masreku. Shtrihet në një sipërfaqe prej 608 km² ose 2.1 përqind e gjithë territorit të Shqipërisë. Dukagjinasi kanë lënë gjurmë në histori, duke kontribuar në luftë kundër çdo pushtuesi. Në vitet e rilindjes Kombëtare, si ato në vitin 1835-1836, në vitet 1854 e 1881 duke luftuar me 300 luftëtar në malin e Taraboshit. Gjithashtu kanë marrë pjesë në vitin 1878 në mbrojtjen e tokave shqiptare të Ulqinit, Tivarit, Hotit e Grudës me mbi 200 luftëtarë. Në Lidhjen e Prizrenit më 15 qershor 1878 Dukagjini përfaqësohej nga kryetari Mark Lula, Marash Kola e Gjek Gega. Marrëdhëniet me fqinjët kanë qenë të shkëlqyera, duke qëndruar përkrah tyre në çdo rrezik që u kanosej. Djelmnia e Shalës e pastaj e gjithë Dukagjinit me në krye Mehmet Shpendin e krijuar në vitin 1890, qëndrojnë për krah Dedë Gjon Lulit në përpjekjet për Pavarësinë e Shqipërisë. Në vitin 1915 duke luftuar për mbrojtjen e tro-

jeve, kundër ushtrisë malazeze dhanë jetën 104 luftëtarë. Dukagjinasi kanë kontribuar ndjeshëm edhe në luftën për çlirimin e Shqipërisë nga nazi-fashistët, me çetën partizane të saj, e cila u krijua me 5 nëntor 1943 me 32 luftëtarë. Nisur nga sa më sipër vërtetohet se Dukagjini ka pasur marrëdhënie të mira me fqinjët e saj, si, me Malësinë e Madhe, Nikaj-Mërturun, Malësinë e Gjakovës, Berishë, e te tjere. Dukagjini dhe dukagjinasi janë të njohur për besë, bujari, burrëri e trimëri. Këto të trashëguara brez pas brezi e deri në ditët e sotme. Dukagjini gjithmonë ka nxjerre figura të ndritura, ndër të cilat mund të veçojmë: Mark Lula, Mehmet Shpendi, Gjek Gega, Mark Sadiku, Lulash Mala, Lulash Gjelloshi, Mark Prel Ujka, Mirash Pali, Gjon Marashi, Bal Marku, Kushë Micja, Zina Franja, Kolë Prela, Martin Camaj, Vas Kiri, Dedë Thani, Ndokë Gjelloshi, Mark Plani, Ndue Logu, Mirash Binoshi, Marash Kola, Kole Gjoka, Ndreke Luca, Tinka Kuerti, Pjeter Gjoka, Gjon e Lec Shllaku, Marie Shllaku, Benardin Palaj, Nikoll Gjini, Zef Shoshi, Luigj Marlekaj, Daniel Gjecaj, Pal Mirashi, Lin Shllaku, Mirash Vuksani, Shaqe Nika, Pina Thani e Vera Bregu.

Në vijim të figurave të ndritura të Dukagjinit që janë të shumta. Por ne po ndalemi te disa prej tyre, të cilët kanë marrë tituj shkencor siç janë: Profesor Doktor Lekë Sokoli, Ndokë Marku, Vuksan Kola, Tonin Gjura, Zef Gjeta e te tjerë. Lëvizjet demografike të popullsisë kanë qenë të pranishme në të gjitha kohërat. Të theksuara kanë qenë pas viteve 90'. Ndryshe nga koha e monizmit ku lëvizjet e popullsisë kanë qenë me pikatore sidomos për zonat veriore. Lëvizje demografike ka pas nga Dukagjini, në vitet 1950-1960, kur i thur edhe kënga "Dukagjinasi zbrit nga mali, merre tokën që ta fali". Në këtë nisëm me dhjetëra familje u zhvendosen nga zona e Dukagjinit. Dhe u vendosen në rrethinat e Shkodrës, Nënshkodrës, në Lezhë e Kurbin, ku u sistemuan rreth

400 familje. Por kjo nuk zgjati shume se u kompozua kënga tjetër "Dukagjinasi ik nga fusha ngjitu malit si arusha". Me dhjetëra familje ikën përsëri e dolën në malësi, kjo në një masë më të vogël. Dukagjinasi në qarkun e Lezhës kanë bërë një emër të mirë. Integrimi i tyre në këtë mjedise u bë shpejt, falë atyre virtyeteve të larta që kanë mbartë me vete si besën, bujarinë, inteligjencën e trimërinë. Këto veti i gëshetuan me mënyrën e jetesës, kulturën e dashamirësinë e komuniteteve të tjera. Si rrjedhojë u arritën të bëhen krushqi e miqësi. Është për tu pasur zili bashkëjetesa në mes Dukagjinave e komuniteteve të tjera dhe ajo ndërjetare.

Dukagjinasi luajnë një rol të rëndësishëm në këtë drejtim. Nuk mund të lë pa përmendur disa familje të vjetra, të cilat janë bërë simbol i të mirës në marrëdhëniet me komunitetet e tjera si: familjet e Ndreke Marashit, Tom Gjonit, Kolë Shalës, Lulash Dashit, Kolë Gurit, Can e Shan Grimcit, Kole Mustafës nga ku ka marrë emrin edhe lagja e Shaljanëve. Familje të cilat fituan respektin e vendasve, me sjelljet e tyre dhe virtytet që mbartin duke u a lënë trashëgim edhe brezave të tjerë.

Në qarkun e Lezhës sot afërsisht jetojnë 1180 familje me 8180 banorë të shpërndarë në Lezhë, Kurbin e te tjera. Dukagjinasi kontribuojnë në administratën shtetërore dhe në biznes, shumë pak të përfaqësuar në pushtetin vendor, për të mos thënë hiç. Nga ky komunitet ndonëse i vogël ka nxjerrë kuadro në të gjitha fushat. Vlen të përmendim disa prej tyre si Mhill Marku i cili ka qenë disa vite zëvendës Ministër i Punëve të Jashtme. I ndjeri Vatë Braka ka qenë për shumë vite Sekretar i Komitetit Ekzekutiv të K. P të rrethit Lezhe. Tonin Voci, prej 23 vite që shërben në strukturat e Policisë së shtetit, në funksione të rëndësishme drejtuese si drejtor i Policisë së Tiranës, të Durrësit e aktualisht drejtor Drejtorie në Ministrinë e Brendshme.

Kuadro drejtues në Lezhe, prej shume vitesh janë dalluar Dedë Marashi, Nipollë Vocja, Fan Barku, të cilët kanë drejtuar sektor të rëndësishëm të ekonomisë duke ngritur lart emrin e mirë të prejardhjes së tyre. Këta kanë treguar se Dukagji-

nasi është i zgjuar, inteligjent dhe organizator i mire. Nga Dukagjini ka me dhjetëra kuadro e specialist të profileve të ndryshme deri edhe me grada shkencore.

Në këtë shkrim po përmendim disa prej kuadrove të cilët punojnë në qarkun e Lezhës, ndër të tjerë veçojmë: Shan Gërdhata, Mirash Ftoni, Lulash Barku, Mirash Baruni, Ndash Ndrëshaj, Bale Mushëq, Gjin Stenaj e te tjerë. Krahas këtyre kanë dalë edhe sportistë të cilët kanë bërë emër si Fran Ndoj e Fran Shkrepi e te tjerë. Ashtu siç kanë dalë edhe instrumentist të zotët si Kolë Guri, Gjekë Boka, të cilët kanë përfaqësuar Lezhën brenda e jashtë atdheut. Nga ky komunitet ka dhjetëra biznesmen të cilët dallohen në ekonominë e tregut të tillë janë: Kolë Shkrepi, Angjelin Lamthi, Angjelin e Arben Fusha, Agim Vocaj, Erdit Marku, e te tjerë. Në qarkun e Lezhës janë me dhjetëra ekonomist, inxhinier, mjek e arsimtarë të cilët rrezatojnë dije e kulturë bashkëkohore.

I themi këto për Dukagjinasi e qarkut Lezhës për të nxjerrë më mirë në dritë anët pozitive të tyre, por edhe për të dëshmuar se ky komunitet ka nevojë për një organizim më të mire e të kualifikuar, për tu bërë faktor në mes komuniteteve të tjera. Njëkohësisht për të luftuar më me efikasitet disa dukuri negative të trashëguara ose të fituara gjatë periudhës si vrasjet, vjedhjet, ngatërresat etj, ndonëse me pikatore, por janë të pranishme.

Mendoj se me votën e tyre gjatë zhvillimit të zgjedhjeve, duhet që të marrin masa për tu votuar edhe nga ky komunitet persona me integritet në pushtetin vendor apo qendror. Duke filluar nga qeverisja e fshatrave, bashki, komuna e deri në Parlamentin Shqiptar. Partitë Politike nuk bëjnë mirë që nuk propozojnë intelektual Dukagjinasi që të përfaqësohet ky komunitet në Qeveri e në Parlament apo edhe në nivelet e dyta e të treta.

Ky komunitet me histori të shkëlqyer e të njohur që në lashtësi e deri në ditët e sotme, për qëndresën ndaj çdo pushtuesi e regjimi, i ka kushtuar jo pak kësaj krahi për të mbrojtur trojet, nderin e traditat.

Nga **Ndue ZIQI**

ESE: BISEDE ME NJERIUN E MUNGUAR

Isha vetem tre muajshe, kur babai im u nda nga jeta. Nuk munda ta njoh, as te beja nje bisede me te apo t'i dhuroja nje puthje. Une tashme jam rritur dhe me mungon prania e tij sepse eshte e veshtire te rritesh pa njerin prind. Prita shume vite, prita se doja qe nje dite te vinte tek shkolla dhe te me merrte ashtu si prinderit e tjere. Por jo, ishte e kote kjo pritje. S'me mbeti asnje kujtim nga ai, vetem fotografite dhe varri i tij. Çdo dite e çoj mendjen tek ai, çdo dite mendoj per te. Si do ta shpreh kete merzitje nuk e di as vete. Me keshillojne te shkoj tek

varri i tij dhe te bisedoj me te. Kete gje nuk mundem ta bej shpesh, sepse kur largohem nga varri i tij, me duket sikur une e braktis ate dhe ia kthej shpinen per ta lene pas. Nje dite mora nje tufe me lule dhe shkova te varri. U ula prane tij dhe thashe: Ja tek erdha tek ti, po ti tek une pse nuk vjen? Kush te ndalon? Jane bere katermbdhjete vite qe te pres e nuk vjen, kurse une erdha. Te lutem me merr me vete te jetojme bashke, te te therras nje here "BABA" e te me degjosh ti. E ti te me thuash: "EJA BIJA IME" e te me puthesh ne balle e te me perqafosh, e pastaj te them qe nuk jam me jetime, edhe une kam dy prinder. "O babi im, te gjithë njerezit qe te njohin me thojne se te kam ngjare ty, e per kete jam e lumtur e krenare. Me fal, o babi qe qaj kur flas me ty, e di qe me sheh nga lart. Edhe ti ndoshta merzitesh kur me sheh me lot ne sy, por kete gje e bej nga malli qe kam per ty. Çdo vit per ditelindje, me urojne gjithë familja dhe te



afermit. Edhe nga jashte shtetit me vijne mesazhe te bukura, vetem urimi jot mungon. Te pres gjithë ditën te vish dhe te me thuash -U befsh 100-vjeçe bija ime! Diten s'erdhe, po pse as ne enderr nuk vjen? Kurse une nuk e harroj ditën e ditelindjes tende. Çdo vit me datën 7 Maj, sa

hap syte ne mengjes, them me mendje: -U befsh 100 vjeç babi atje ku je, lart ne qiellin e bukur, ku dielli vezullon. Por as ditën e vdekjes nuk e harroj. Ate datën 6 tetor, ajo dite per mua eshte dite e zeze, ate dite e mallkoj me gjithë zemer, sepse ate dite e pas nuk te pashe me me sy, nuk te preka. Trupi yt u mbyll ne kete varr, ne kete mermer ku eshte shkruar data e lindjes dhe vdekjes dhe fotoja jote. Kur çoj syte dhe shoh foton tende, me duket sikur je duke me shikuar dhe je gjalle, dhe sikur je prane meje dhe une flas me ti nuk me pergjigjesh, vetem me shikon. Marr rruget per ne shtepi, sjell koken mbrapa dhe ti vazhdon te me shikosh. Zgjas doren te te marr me vete e te vish me mua, por jo, prap qendron atje ne varr i mbyllur.

LILJANA ZOJZA
KLASA: IX
SHKOLLA: DEDE GJON LULI
HOT I RI

MONOGRAFIA "SHOSHI"

Me datën 4 nëntor 2012, nga Shoqata "Atdhetare-Dukagjini", u organizua ceremonia e paraqitës së librit, monografi "Shoshi" me autor Prele Milani. Në këtë ceremoni morën pjesë anëtar të shoqatës "Atdhetare-Dukagjini", banorë të komunës së Shoshit dhe miq, familjare e të afërm të autorit. Nderuan këtë ceremoni, Mjeshtri Fadil Kraja, Kryetari i Këshillit të Qarkut Shkodër, Maxhid Cungu; Kryetari i Këshillit të Bashkisë së qytetit të Shkodrës, av. Bardhyl Lohja; Mjeshtri Ahmet Osja dhe Ndoc Gurashi, biznesmeni amerikano-dukagjinasi, Ndue Ftoni, shkrimtari Ndrek Guri e të tjerë.

Këtë ceremoni e përgatiti Aleks Dushi dhe e drejtoi aktorja e teatrit "Migjeni", Rajmonda Marku.

Ajo, pasi beri prezantimin e objektit, ju uroj mirëseardhjen pjesëmarrësve, i dha fjalën redaktorit të librit, poetit Lazer Kodra, i cili në mes të tjerave u ndal në vlerat e këtij libri, duke bere një përshkrim esencial të të dymbëdhjetë kapitujve të librit si dhe te veçantat që

paraqet ky libër përse i përket mënyrës se kompozimit të tij.

Folën në këtë ceremoni: prof. dr. Mahir Hoti, Mjeshtri Fadil Kraja; kryetari i



shoqatës "Atdhetare-Dukagjini", Ndue Sanaj, Ndrek Guri, kryetari i këshillit të Qarkut, Maxhid Cungu, mësuesi Tonin Vasa, mundësori i kësaj veprimtarie, Ndue Ftoni dhe autori i librit, Prele Milani.

E gjithë veprimtaria u shoqërua nga leximi i pjesëve me interesante të librit, nga recitime të poezive të ndryshme, si dhe i pjesëve humoristike të autorit, aq te bukura sa na keqen.

Ne fund në emër të kryesisë së Shoqatës "Atdhetare-Dukagjini", kryetari i saj, Ndue Sanaj lexoi vendimin e kryesisë për nderimin e disa figurave të krahinës së Shoshit: Me titullin "Anëtar Nderi" të shoqatës, Profesor Kole Prelen, pas vdekjes, me motivacion: "Intelektualit dhe mishëruesit të ndërgjegjes popullore në kërkim të fjalës së lire. Njeriu që e dha jetën për idetë e konsoliduara demokratike Evropiane. Shëmbëlltë e pashoqe e vetëdijes intelektuale"; At' Ciprina Nika, me motivacion: "Ministër provincial i Kishës Katolike Shqiptare. Përçues i fjalës së Krishtit. Një univers i vërtetë i vlerave poliedrike. Qendrestar deri në vdekje për kauzën njerëzore"; Dom Preke Ndrevasaj, me motivacion: "Figure elitare e inteligjencës sonë të mërgatës. Tribunal i fjalës së Zotit dhe arsyes njerëzore kudo në botë. Shqiptari i gatuar me shqiptarizëm"; Kengetarin Frederik Ndoci, me motivacion: "Prototip i ndërthurjes së vlerave muzikore tradicionale dhe atyre

moderniste. Pjalmi modernist shqiptar në universin e muzikës evropiane"; shkrimtarin Ton Gasper Shoshi, me motivacion: "Dramaturgut të mirënjohur shkodrane, stilisti i shkëlqyer i dialogjeve dramatike, skeçeve humoristike e pjesëve satirike. Ngjyresa e veçante në lëmin e dramaturgjisë nacionale"; dr. Gasper Shoshi, me motivacion: "Filolog dhe filozof i njohur. Poliglot dhe univers rrezatues i pedagogjisë dhe historisë shqiptare. Erudit i përmasave evropiane. Fitues i kampionatit të pare nacional të shahut në vitin 1946"; me titullin "Mirënjohja", Gjëllosh Lulashi, me motivacion: "Anëtarë i shoqërisë së Bashkimi Demokristiane. U flijua në mbrojtje të ideve të tij përparimtare. Shembull qëndresë përballë regjimit komunist".

Me këtë rast falenderojme në mënyrë të veçante mundësorin e botimit të këtij libri, emigrantin Martin Gjoni, dhe mundësorin e kësaj veprimtarie Ndue Ftoni, biznesmen në SHBA, si dhe grupin e përgatitjes së kësaj ceremonie me shume dinjitet e profesionalizëm, me në krye anëtarin e kryesisë, Aleks Dushin.

Nga korrespondenti
I gazetës "Dukagjini"

FLAMURTARËT E SHOSHIT NDËR BREZA


Me datën 17 nëntor 2012, në mjedisin e bar-restorant "Kolpingu", u bë prezantimi i monografisë së familjes Lulash Gjëlloshi, me titull "Flamurtarët e Shoshit ndër breza", me autor Eduard Çiurçija. Në këtë ceremoni morën pjesë banorë të krahinës së Shoshit, miq dhe të afërme të familjes Ashta, të ftuar e të tjerë që e bënë më jetedhenese këtë ceremoni.

Ceremoninë e hapoi, Dede Lulash Ashta, i cili falënderoi pjesëmarrjen në këtë ceremoni, foli për jetën e kontributet e kësaj familje në shekuj. Pastaj e mori fjalën redaktori i librit dr. Vinçens Marku, kryetari i komunës së Shoshit Mark Kulla, kryetari i shoqatës "Atdhetare-Dukagjini", Ndue Sanaj dhe në fund foli autori i librit, Eduard Çiurçija, i cili falënderoi pjesëmarrësit, ata që shprehën mendime për librin dhe përgjegjësinë që ka marre përsipër për të shkruar këtë monografi familjare.

Këtë ceremoni e drejtoi mesuesi Kadri Fikaj, me shume profesionalizem dhe larmi.

Kjo ceremoni u mbyll me një koktej të bollshëm dhe me shume bujari, ashtu siç e ka pasur në tradite kjo familje dhe krahina së ciles i përket.

Nga korrespondenti I gazetës "Dukagjini"



GJOVALIN LUKA


Me datën 27 nëntor 2012, në mjedisin e bibliotekës "Marin Barleti", u zhvillua ceremonia e prezantimit të librit "Gjovalin Luka, refleksione, bisedime, divergjenca, debate me Enver Hoxhën, me 28 nëntor 1944-18 qershor 1955", me autor Agron Luka.

Në këtë ceremoni morën pjesë dr. Gjovalin Çuni-drejtori i bibliotekës "Marin Barleti", dr. Qazim Gjyrezi e prof. dr. Mahir Hoti-pedagoge të Universitetit "Luigj Gurakuqi", Gjergj Perluca-kryetari i shoqatës së "Integritimit në Evropë" e të tjerë.

Autori, Agron Luka, pasi ju uroj pjesëmarrësve mirëseardhjen, foli për punën që ka bere në hulumtimin e studimin e botimit e materialeve që tregojnë refleksionet, bisedimet, divergjenat, debatet në mes Gjovalin Lukes dhe Enver Hoxhes prej një periudhe rreth 11 vjet, të cilat kane bere që Gjovalin Luka të dënohet deri në internime dhe të përndjeket deri në vdekjen e tij dhe jo vetëm ai, por edhe familja e tij. Ky debat dhe ky dënim edhe përndjekje ndaj tij e familjes së tij, ishte për pikëpamje të kundërta ideologjike apo pse Gjovalini ishte katolik, apo te dyja së bashku? Është një pikëpyetje e madhe, për të cilën Agron ka bere përpjekje të paraqes te dyja e ti argumentoje ato.

Fjalën e mori dr. Qamil Gjyrezi, i cili në mes të tjerave e përgëzoje Agronin, autorin e librit për punën që bën. Pastaj dha opinion edhe Gjergj Perluca, i cili në mes të tjerave theksoi: Mos përfaqësimi ka gene i hershem dhe ky mos përfaqësim vijon dhe sot. Kjo duhet të ndreqet sa më pare në qoftë se duam që të kemi një shtet demokratik, një shtet ligjor, një shtet të së drejtës. Për këtë, ka fakte sa të duash që vërtetojnë mentalitetin e shumicës mbi pakicën, duke shkelur të drejtat e pakicës qofte etnike, fetare apo krahinore.

Nga Korrespondenti i gazetës "Dukagjini"



DUKAGJINI NË 100 VJETORIN E PAVARËSISË

Me datën 25 nëntor 2012, dega e shoqatës "Atdhetare-Dukagjini" në Tiranë, ne mjediset Muzeumit Nacional, zhvilloi simpoziumin, me temë "Dukagjini në 100 vjetorin e Pavarësisë". Ne këtë simpozium morën pjesë anëtarë të degës, miq nga krahina Nikaj-Merture, simpatizantë të shoqatës dhe djem e vajza dukagjinase, mori pjesë shkrimtari Lazer Stani, poeti Ndue Vatnikaj e të tjerë. Nga kryesia e shoqatës, mori pjesë kryetari i saj, Ndue Sanaj dhe sekretari Luigj Shyti.

Simpoziumin e drejtoi prof. as. dr, Zef Gjeta.

Pas himnit Nacional, prezantimin e programit e urimin e mirëseardhjes së pjesëmarrësve, e beri prof. Zefi.

Me pas u mbajtën kumtesat:

Veterani Marash Kola, mbajti kumtesën, me temë: "Kontributi i Dukagjinit për Liri e Pavarësi që i vazhdueshëm dhe i gjithanshëm".

Kryetari i degës për Tiranën, mësuesi Zef Bari, mbajti kumtesën, me temë: "Figurat dukagjinase ndër vite, kanë meri-



ta të madhe në zhvillimin e kulturës, artit, sportit, mjekisë e të tjera fusha të jetës shoqërore të vendit".

Avokati Pal Marku, mbajti kumtesën, me temë: "Traditat e mira të zonës sonë,

baze e identitetit dhe i vlerave tona edhe për të ardhmen".

Shkrimtari Lazer Stani, mbajti kumtesën, me temë: "Dukagjinasi po integrohen jo vetëm zonat urbane, por dhe

ne vende të ndryshme të Evropës dhe në mbare botën deri në SHBA e Australinë e largët".

Ne fund përshëndeti dhe kryetari i shoqatës, Ndue Sanaj, i cili pasi solli arritjet e shoqatës në këtë jubile të Pavarësisë dhe në dhjetë vjetorin e krijimit të saj, në baze të vendimit të kryesisë së shoqatës, nderoi me titullin "Mirënjohja" e shoqatës: Degës së Shoqatës "Atdhetare-Dukagjini", për Tiranën, me motivacion: "Për vullnetin e mire, këmbënguljen e vazhdueshme, pjekurinë e madhe dhe ndihmesën e përhershme në ngritjen dhe funksionimin e shoqatës në realizimin e misionit të saj. Në punën e bere në integrimin më të thellë të komunitetit tonë në jetën e shoqërisë demokratike"; Nike Pali, pas vdekjes, me motivacion: "Veprimtar i palodhur në shërbim të shoqatës, komunitetit dukagjinase dhe gjithë shoqërisë, si qytetar dhe anëtarë i shoqatës, në veçanti në detyrën e kryetarit të parë të degës së shoqatës "Atdhetare-Dukagjini" për Tiranë" dhe Gjergj Vocaj, me motivacion: "Për përkushtim të vijueshëm dhe për kontribute financiare që ka dhënë Shoqatës "Atdhetare-Dukagjini", në realizimin e misionit të saj"

Nga Korrespondenti i gazetës "Dukagjini"

Ndoke Gjeloşi, i pari shqiptar që ngriti Flamurin Nacional në Shkodër

NE SHKODRËN E MBETUR PA FLAMUR SI REZULTAT I LUFTËS TURKO-MALAZEZE, AI ME BEKIMIN E FISHTËS NGRITI FLAMURIN SHQIPTAR MBI KISHËN E FRETËRVE

- Ku janë burrat e motit?

- Ku asht barku i Oso Kukës dhe i vargjeve të tjera të dëshmorëve që ranë për këtë tokë të shenjtë? Fretnit që gjindeshin pranë tij, kishin mbetur të shtangun prej shprehjeve që ai lëshonte

- Ju kam thanë edhe një herë tjetër, - briti me za të kumbueshëm poeti.

- Asht ma kollaj me mbledhë një thes pleshta se dy shqiptarë bashkë! Mandej duel me shetitun nëpër qytet. Flamujt e huaj baheshin shtiza që futeshin thellë në trupin, në gjakun e tij.

Një neveri, një ftoftësi, një përbuzje për gjithçka shihte rrotull iu fut ngadalë si një helm, aty brenda në gjoks titanësh.

- Ku asht flamuri i Shqipnisë?...

- Ku e kemi flamurin e madh?...

I sollën flamurin. E pa, ishte i madh sa t'ana shpresat; ishte i bukur si vdekja ma e dëshiruar, ishte krenar që mund të jetë krenare vetëm një shqipe.

- Këtë flamur duhet ta ngjeshim mbi kambanjalën e Kishës sonë. - urdhëroi.

- E po t'ia mbajë Internacionales e Malit të Zi le të vijë e ta hjekin. Duhet t'u tregojmë të huajve se fisin tonë e bëmë vetë me gjakun tonë.

- Shkoni e thirrni Ndokë Gjeloşin; i



thoni se unë due prej atij çka mund të lypë një mësues prej një nxansi që të mos na korisi, pra le të hypi ai mbi kambanjele, le ta lëshojë ai me duart e veta, Flamurin.

Unë e di se ai asht trim.

Ndërsa Ndokë Gjeloşi ngjiste flamurin e ngadhnimeve tona ma të shkëlqyeshme, atje nalt, nalt. Ndërsa valët e emblemës tonë fillojshin me u tundun në atë mbasdite të mallëngjy-



eme vjeshte, poeti tue soditun nga kjo Shqipëni valuese, këndoi aty për aty "Hymnin e flamurit":

Por si fleta e ëjllit të Zotit

Po rreh flamuri i Shqipnisë

E thrrret bijtë e Kastriotit

Me u mbledhë t'tanë n' çetat ushtrisë

...

Kur e panë flamurin shqiptar mbi kambanjel të Kishës së Fretëve ... s'vonoi shumë dhe një kolonel anglez u paraqit te

porta e Kuvendit. Poeti e priti kolonelin ingliz me përbuzje ..., kur ai shfaqti mendimin që flamuri duhet të hiqej prej Kambanjelit, përndryshe do të ndodhin ndërlikime mes shqiptarëve e malazezëve, Fisha iu kundërpërgjigj: Ne s'kemi aspak frigë prej nderlikimesh. Na s' do ta ulim kurrë ma atë flamur!

- Atëherë do të na shtrëngoni të përdorim topat për ta ulun, - u kërcënuan anglezi.

- Ju falemindersë, - i bani poeti.

- Për nderimin që po i bani flamurit shqiptar, atij me të vertetë i ka hije me u përshëndetë me topa 22.

Ndokë Gjeloşi e adhuronte Fishtën jo vetëm si poet i pashoq, por edhe si njeri, prandaj pranoi me kënaqësi kërkesën e rreptë të mësuesit të tij. Të ngulje shtizën e flamurit tënd gjakvadtur pas pesë shekujsh robërie dhe ta valvisje mes rrebeshit të menxurshëm të bombardimeve të parreshitura të armikut, ishte privilegj dhe nderë i madh historik.

Ky filiz i hijshëm dhe madhështor i Dukagjinit, vazhdues i denjë i fatosave që s'kanë të harruar kurrë në histori, ky burrë i shkathët dhe plot gjallëri, flamurin e donte mbi gjithçka. Të vriteshe dhe të vdisje për të, ishte krenari.

Besimi dhe dëshira në përmbushjen e detyrës historike që e pakufishme, e pakushtëzuar, ngazëllyese pasi buronte nga shpirti liridashës. Tek ai flamur shihje dritën e amshuar të lirisë dhe bekimin e vërtetë të së ardhmes.

Prele Milani: Fragment nga libri "Atentati që tronditi dy shtete", fq. 32-34, botim i vitit 2012

VLERËSOHET DHE NDEROHET DOKTORI I DUKAGJINIT

Pak ditë më parë ishim pjesëmarrës në një veprimtari mjaft prekëse dhe domethënëse. Them prekëse sepse në sytë, në shpirtin dhe fjalën e të gjithë pjesëmarrësve shihje dhimbjen për ndarjen e parakohshme nga jeta të njërit prej figurave më të shquara intelektuale, qytetare dhe profesionale Doktor Prel Gjeloshit. Nën tingujt e himnit kombëtar, në një ditë të zbehte nëntori dhe në praninë e qindra pjesëmarrësve, Këshilli i Komunës Rrethina me një vendim unanim të marrë pak ditë më parë, i ka dhënë dr. Prel Gjeloshit titullin "Qytetar Nderi" i Komunës Rrethina pas vdekjes. Gjithashtu këshilli i komunës ka vendosur që Qendra Shëndetësore e kësaj komune në fshatin Grudë e Re, të marrë emrin "Qendra Shëndetësore Dr. Prel Gjeloshi, Rrethina".

Ajo që na bëri përshtypje dhe që ja vlen për t'u theksuar është pjesëmarrja masive e banorëve të kësaj komune, miqve, kolegëve dhe të afërmeve të dr. Prel Gjeloshit në këtë ceremoni.

Ishin të pranishëm përfaqësues të Këshillit të Qarkut Shkodër, të Drejtorisë rajonale të shëndetit publik, përfaqësues të komunave të Dukagjinit dhe të mediave lokale.

Në fjalën e tij, kryetari i këshillit të komunës Rrethina, Lulash Nika, tha: "Ndjejmë dhimbje dhe respekt tek vlerësojmë dhe përkujtojmë punën e palodhur të dr. Prel Gjeloshit për shumë vite në shërbim

të banorëve të kësaj komune. Dr. Prel Gjeloshi ishte njëri ndër kuadrot më të përgatitur dhe të devotshëm të Dukagjinit e më gjerë. Emri i tij i bën nder kurdoherë të gjithë kësaj komune, ku do të ruhet kurdoherë i gjallë e i paharruar portreti i tij si mjek dhe si njeri i jashtëzakonshëm. Dr. Prela do të mbetet gjithnjë i dashur e i respektuar edhe për të gjithë ne.

Irena Shestani, foli me shumë respekt për vlerat profesionale dhe qytetare që doktori ka pasqyruar me punën e tij. Jeta dhe vepra e dr. Prel Gjeloshit u ka bërë një nder bluzave të bardha dhe profesionit të shenjtë të mjekut. Ai ishte modeli i korrektesisë, i përkushtimit dhe i sakrificës në punën e tij. Tek flisnin njëri pas tjetrit kolegë dhe miq të tij, shihje sesi pasqyrohej dhimbja dhe respekti në fytyrat e qindra të pranishëmve që ndodheshin atë ditë pranë qendrës shëndetësore Grudë e Re.

Aty shihje se bashkoheshin në një dhimbja dhe krenaria, respekti dhe vlerësimi, dhimbje për humbjen e parakohshme të një personazhi që ka lënë gjurmë të pashlyera në kujtesën e të gjitha atyre që patën rastin të jenë pacientët e tij. Krenaria e heshtur por e merituar e bashkëfshatarëve të tij të fshatit Kirë, e të banorëve të Dukagjinit, të cilët do të ndihen gjithmonë krenar për djalin e tyre. Për pjesëtarët e familjes, për djemtë Klodin dhe Benardin, bashkëshorten e tij, vëllezërit dhe motrat, kjo ditë do të

mbetet e paharruar, sepse e panë edhe një herë se me dhimbjen e tyre bashkohet një komunitet shumë i gjere.

Foli për të pranishmit edhe djali i madh i dr. Prelës, kirurgu i ardhshëm Klodiani. I falënderoj të gjithë, i emocionoj të gjithë, dhe ju premtoj se do të përpiqet të eci në gjurmët e profesionalizmit dhe përkushtimit të të atit në profesionin e nderuar të mjekut.

Krejt i veçantë ishte momenti kur në dhomën e mjekut, ku dr. Prela ka punuar për shumë vite bluzën e bardhe e veshi djali i tij, Benardi student për mjekësi në Firence Itali. Pashe se si përloje një infermiere, pashe se si largohej duke qarë një tjetër, se si e përqafojnë djalin koleget e doktorit dhe ndjeva vërtet emocion...

I bindur se jetën tone e ka në dorë vetëm Zoti, sepse përndryshe dr. Prela do të ishte përsëri aty, por i bindur se njerëzit e ndershëm dhe të përkushtuar gjithmonë do të vlerësohen. Kjo më bëri që të shtri bisedën edhe me gazetarë dhe përfaqësues të tjerë që ndodheshin aty...



Të tjera vlerësime, të tjera materiale po përgatiten për të respektuar dhe nderuar këtë njeri të palodhur, që u nda para kohe nga jeta por la një emër, një vepër, meriton të vlerësohet...

Nga Lulash Brigja

poezi *** poezi *** poezi *** poezi *** poezi*** poezi *** poezi*** poezi *** poezi

MIREMENGJES O SHQIPERI

Miremengjes o Shqiperi
Gezuar 100 vite pavarsi
Te shumta urime te vijne sot
Si fanar ndriçon ne bote.

Mjaft me vuajtje e mundime
Sa fitore e realizime
Megjithë sfidat qe kalove
Shkemb graniti ti qendrove.

Gjithe shqiptaret anembane
Me nje zemer te thane:Nanë
Dhe gezojne ne kte ditë sot
N`emwer tand kudo ne botë.

Lum si ti o Shqiperi
Në tan boten ke rini
Që ta mbrojne shpirtin tan
Në Evrope e ne Ballkan.

Bijte e tu sot janë krenarë
Qe e kan emrin shqiptetar
Ne çdc vend te kesaj toke
Kudo njihet vepra jote.
nga GJYSTINA LUMAJ

PËR 100 VJETORIN

Ane e mban ne shqiptari
Po valëvitet pa pertes
Një flamur i kuq si gjaku
Me një shkabë te zeze ne mes

Ne Vlore një qind vjet me pare
U ngrit, u valëvit
Ne Vlore njëqind vjet me pare

Pavarësinë përtërite

Një flamur i madh sa qielli
Po mbulon sot shqiptarinë
Valëvitet gjer te dielli
Shqipërinë e gëzosh pavarësinë

O Flamur simbol i jone
Sa I shtrenjte je për ne
Jetën te paret tanë dhanë
Për ty e për atdhe

Çdo shqiptar nga zemra e vete
Një urim nis dhe thërret
Fort me tere fuqinë
Shqipëri gëzosh 100 vjet pavarësi
Nga GJOKARRA

JAM SHQIPTAR ...

Po më holle në zjarr
bëhem flake !!
e vete nuk shuhem pa të djeg ty

Po më holle në det
bëhem dallge e nuk mbytem...
pa të fundosur ty

Po më le mbi toke
fluturoj n'hava
sepse nena ime Shqipe emrin e ka

Po më fute nën dhe
dije se jam gjalle
sepse gjaku i t'pareve këtu bëhet ar???

I ri ndoshta të dukem

por unë jam plakush
jam n' keto troje më parë se askush!!!

Në det e në toke
në qiell e në dhe ..??
Jam zot i kesaj toke e këtu më ke???

BESO ...???

Kur ndonjëherë të jesh i lodhur nga jeta
I helmuar në shpirt i sfilitur për vdekje.
Ki durim, qetsohu ...
sepse e ka një zgjidhje.

Ndonjëherë kur zogjtë
të duket se qajnë
dhe lulet e pranverës të duken kufoma
Kujto këtë që po të them,
... sepse e ka një zgjidhje.

Ndodh që të kesh gabuar,
mundet edhe të jesh fajtor
Veten mos e mallko kot,
Qetsohu, kërko një zgjidhje,
sepse jeta vazhdon.

Kur të ndihesh ndonjëherë i vetmuar
Dhe të duket se të gjithë i ke kundër
Kërko ndihmën e Zotit
Më beso. Ai është me ty.
Nga LULASH BRIGJA

Urojmë z.Gëzim Vuçaj për botimin e numrit të parë të gazetër "SHKABA".